



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 52 Akti

Nr. 53 Vendimi

Tiranë, më 31.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në Tiranë, më datë 27 korrik 2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Artan Broci, gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci, në seancë dëgjimore publike, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Artan Broci është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi nga trupi gjykues nr. 4.

2. Me vendimin nr.1, datë 12.12.2017, të trupit gjykues, është vendosur kryesuese znj. Xhensila Pine, është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe fillimi i hetimit administrativ kryesisht nga relatori. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga:

a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016;

b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe

c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

5. Përgjatë komunikimit elektronik me subjektin e rivlerësimit, në datën 29.3.2018, ai i është drejtuar komisionit (komisioner, relator, anëtarë të komisionit) për:

“1. Vënien në dispozicion dhe marrje të kopjeve të akteve të:

a) Raportit të ILDKPKI-së;

b) Raportit të DSIK-së;

c) Raportit të KLD-së.

2. Vendimi i arsyetuar i relatorit apo i trupit gjykues (komisionerëve) për fillimin e hetimit të thelluar administrativ kryesisht apo me kërkesë (procedurës administrative).

3. Të gjitha kopjet e akteve (shkresore, dëshmi, raporte, ekspertiza, mendime të shprehura) të marra te të tretët në procedurën administrative, që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit apo familjarët e tij.”

5.1 Këtij komunikimi elektronik të subjektit, iu përgjigj relatori në datën 4.4.2018, duke e sqaruar lidhur me procedurën që ndjek Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për njoftimin e subjektit të rivlerësimit mbi njohjen me aktet në dosje, si dhe kohën në dispozicion (procedurë e njëjtë që zhvillohet me të gjitha subjektet e rivlerësimit).

6. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, paraqiti një ankesë në Komision, mbi refuzimin e kërkesës së tij, ku i drejtohej Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Komisioni, përcolli këtë ankesë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për përbërjen e trupit gjykues në datën 06.04.2018. Ai deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Më datë 20.06.2018, trupi gjykues, bazuar në relatin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Artan Broci, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr.84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e

provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, paraqitjen e shpjegimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

8.1 Z. Broci iu dhanë 20 ditë kohë për t'u njohur me dosjen, për të disponuar kopje të saj, si dhe për të paraqitur shpjegime ose prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

9. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj.

9.1 Në datën 03.07.2018 ai paraqiti një kërkesë për zgjatje afati, për parashtrimin e mbrojtjes në lidhje me rezultatet e hetimit dhe marrjen e provave. Në datën 09.07.2018 u njoftua subjekti i rivlerësimit se trupi gjykues miratoi zgjatjen e afatit edhe me 7 ditë.

10. Subjekti i rivlerësimit paraqiti brenda afatit të caktuar nga Komisioni prova të reja dhe shpjegime lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit.

11. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore të datës 27.07.2018, ora 13:00, me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 25.07.2018.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 27.07.2018, ora 13:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

13. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë, ai paraqiti shpjegime lidhur me hetimin e bërë kryesisht nga Komisioni. Z. Broci paraqiti provat ku mbështeteshin shpjegimet e tij, të noterizuara, në përputhje me ligjin për noterinë në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.84/2016. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në "Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting".
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Inspektorati i KLD-së, së bashku me materialin shoqërues.
- ç) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
- d) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik, si dhe deklarata nga dëshmitarë.
- dh) Fakte të prezumuara nga ligji dhe denoncimet nga publiku.
- e) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe në seancën dëgjimore.

15.1 Trupi gjykues, gjatë hetimit të çështjes, administroi:

- a) Përgjigjet shkresore/opinion nga ILDKPKI-ja.

- b) Dokumente të tjera shkresore, nga organet publike dhe private, përveç atyre që ka administruar ILDKPKI-ja.
- c) Dokumente të tjera shkresore, përveç atyre që ka administruar DSIK-ja.
- ç) Mendim i specializuar nga Inspektorati i KLD-së, dokument ligjor/fakt i prezumuar nga ligji, mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
- d) Prova të reja, përgjigje dhe shpjegime nga ana e subjektit të rivlerësimit.

i. VLERËSIMI I PASURISË

16. Gjatë hetimit administrativ u shqyrtuan dhe u vlerësuan të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke u bazuar në sa më poshtë:

- a) Raportin e vlerësimit dhe dosjen nga ILDKPKI-ja.
- b) Dokumente të tjera shkresore, sipas parashikimeve të neneve 49 e 50, të ligjit nr.84/2016.
- c) Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

17. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

17.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a. *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- b. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

19. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

19.1 Për këtë arsye, nga relatori u ndërmorën hapat e mëposhtëm:

- a) Iu kërkua këshilltarit ekonomik që të hartojë raport mbi situatën ekonomike e financiare të subjektit dhe të japë një opinion nëse subjekti justifikon me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera ndër vite pasuritë e deklaruara.
- b) Iu kërkua këshilltarit juridik të japë një opinion në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve juridike të kryera prej subjektit të rivlerësimit dhe konfliktit të interesit.

¹Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

c) Iu kërkua subjektit në adresën elektronike të japë informacion shtesë, sipas pyetjeve të dërguara.

20. Subjekti i rivlerësimit, mbas hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se ka pasuri të paluajtshme si vijon:

21. Pasuria njësi tregtare, 63 m², me adresë blv. “**” (“****”) Tiranë**, e privatizuar me kontratë shitjeje më datë 14.11.1995, midis shitësit Ndërmarrja *** nr. ***, e përfaqësuar nga P. D dhe blerësit D. B, me çmim 63.942 lekë, pronar pa truallin. Pasuria është rivlerësuar në vitin 2012 për vlerën 54.944,000 lekë.

21.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në deklaratën “Vetting”, se kjo njësi është dhënë me qira që në vitin 1996 e në vazhdim.

22. *Mënyra e blerjes së kësaj pasurie* - Kjo njësi tregtare është përfituar me kontratën e shitjes, datë 14.11.1995, nga Ndërmarrja *** nr. ***, Tiranë, me çmim 63.942 lekë. Objekti ka pasur edhe gjendje malli, në vlerë 51.242 lekë. Likuidimi është bërë në lekë për vlerën 10 % të shumës, konkretisht me mandatin e datës 23.03.1995, në vlerë 12.000 lekë, dhe pjesa tjetër me letra me vlerë në vitin 1995.

Hetimi i kryer nga Komisioni

23. Nga verifikimi i dokumentacionit që gjendet në dosjen e ILDKPKI-së konstatohet se janë bashkëlidhur të gjitha dokumentet ligjore të marra nga hipoteka, së bashku me mandatpagesat, dhe kontratën e lidhur.

24. Lidhur me deklarinimin e subjektit se kjo njësi është dhënë me qira që në vitin 1996 e në vazhdim, kjo çështje do të analizohet në kreun “Hetimi administrativ, mbi pasuritë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur”.

25. *Konkluzionet e hetimit*: Përputhen deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me të dhënat e administruara. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

26. Pasuria apartament, sip. 143.81 m², në Rr. “**”, pall. ***, hyrja ***, ap. ***, Tiranë (bashkëpronar).**

27. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është nga bashkimi në vitin 2016 i pasurisë: (i) apartament 78.11 m², me adresë shk. ***, k. ***, ap. ***, *privatizuar falas* (sipas statusit “I përndjekur politik”) nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 1996, dhuruar 1/3-ta e apartamentit, pjesa takuese e nënës së Artan Brocit më 04.04.2012, dhe (ii) apartamentit 65.7 m² (shtesë anësore) me adresë shk. *** k. ***, ap. ***, me prejardhje *leje legalizimi* shtesë objekti, regjistruar më 25.09.2013, vetëdeklaruar si ndërtim pa leje i vitit 1997, vlera e vetëdeklaruar për këtë pasuri është 550.000 lekë.

28. Apartamenti 65.7 m² është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2013 dhe vlera e deklaruar e objektit është 550.000 lekë.

28.1 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri më parë as si ndërtim dhe as si vlerë. Nga informacioni i dhënë nga vetë subjekti i rivlerësimit, kjo pronë është ndërtuar në vitin 1997, si shtesë anësore për të gjithë banorët e atij krahu, (ndërtim pa leje).

Hetimi i kryer nga Komisioni

29. Apartamenti 65.7 m² është një ndërtim pa leje, i bërë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 1997. Ndërtimet pa leje në atë kohë parashikonin masa të karakterit administrativ (gjobë, prishje e objektit dhe kthim në gjendjen e mëparshme). Duhet mbajtur në vëmendje edhe fakti se ndërtimi ishte për të gjithë seksionin e pallatit (shtesë anësore).

30. Referuar deklarinimeve të subjektit të rivlerësimit, vlera e ndërtimit të shtesës (apartament 65 m²) është 550.000 lekë. Nëse i referohemi Vendimit nr.13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit (k)”, ku përcaktohet se: “... *kostoja mesatare vjetore në shkallë Republike e ndërtimit të banesave nga EKB, për vitet 1996 -1997, të jetë 19.581 lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi...*”, për kohën e ndërtimit të shtesës anësore me sipërfaqe 65.7 m² (viti 1997), kostoja mesatare e shtesës së apartamentit ka qenë 1.286.471 lekë (65.7 m² *19.581 lekë/m²).

31. Pa llogaritur shpenzimet për jetesë, shuma e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 1993 - 1997 nuk është e mjaftueshme për ndërtimin e shtesës anësore prej 65.7 m², në këtë banesë, në vitin 1997, në vlerë prej 1.286.471 lekë (referuar kostove mesatare të ndërtimit të banesave sipas Vendimit nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave).

32. Nga hetimi konstatohen pasaktësi në deklaram për pasurinë apartament 65.7 m² (shtesë anësore), duke mos e deklaruar atë në deklaramet periodike vjetore (2004 - 2012) këtë objekt si ndërtim pa leje, si dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare, në kohën e ndërtimit (krijimit të pasurisë).

33. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzionet e hetimit për këtë pasuri.

34. Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

35. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie (apartament 65.7 m²) si objekt, por edhe si shpenzim, që në momentin e posedimit, trupi gjykues i konsideroi bindëse argumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të cilat lidheshin edhe me detyrimet për deklaram sipas ligjit nr. 9049/2003, në atë kohë.

35.1 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, këtë objekt as nuk kam pasur detyrim ta deklaroj, për sa kohë nuk mund të kualifikohej si pasuri e imja, në pronësi, posedim apo përdorim në kuptim të Kodit Civil.”*

36. Më tej, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri, shtesën anësore, menjëherë me fitimin e titullit të pronësisë, në deklaramin periodik vjetor (viti 2013). Ai e ka deklaruar këtë pronë edhe në deklaramtën “Vetting”.

37. Pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, arrihet në përfundimin se subjekti ka deklaruar objektin e ndërtuar (shtesë anësore, ndërtim pa leje) në deklaramtën “Vetting”, por se mbeten pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike vjetore.

38. *Në lidhje me burimet e ligjshme financiare dhe përllogaritjen e kostos së ndërtimit-* Subjekti ka sqaruar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar ndërtimin e kësaj shtese në vlerën 550.000 lekë.

39. Lidhur me përllogaritjen e kostos së ndërtimit të kryer nga Komisioni, e cila u referohej kostove mesatare të ndërtimit të kohës kur ishte kryer ky ndërtim, trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e reja të paraqitura prej tij, vlerëson se ndërtimi i është referuar kontratës së lidhur mes palëve asaj kohe. Ndërtimi ka qenë për të gjithë banorët e pallatit (të atij krahu). Nga kontratat dhe preventivi, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit si provë e re, vërehet se çmimi është 600.000 lekë total, nga të cilat 40.000 lekë janë spostim i pushtetave të ujërave të zeza dhe të bardha, të cilat subjekti ka sqaruar se janë zbritur shpenzimet për to. Në kontratë vihet re se, sipërfaqja e ndërtimit e referuar është 46.3 m², e ndryshme nga sipërfaqja reale e ndërtuar prej 65.7 m². Për këtë fakt, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime.

40. Në përfundim, trupi gjykues ka pranuar provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me deklaramin e bërë për këtë pasuri. Ai pranon t’i referohet kostos së ndërtimit të deklaruar nga subjekti, bazuar në kontratën dhe preventivin e dërguar si provë dhe jo asaj të përllogaritur nga Komisioni, sipas kostos mesatare të çmimeve të ndërtimit të atij viti, nisur kjo edhe nga koha e largët e këtij ndërtimi. Deklaramet e subjektit mbeten kontradiktore lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të përmendur në kontratën e paraqitur si provë e re (46.3 m²) dhe sipërfaqen reale prej 65.7 m² të rregjistruar, të objektit shtesë anësore.

41. Pasuria apartament 157.99 m², me adresë Rr. “**”, pall. ***, hyrja ***, ap. ***, Tiranë (bashkëpronar).** Vetëdeklaruar me vlerë 6.851.600 lekë.

41.1 Krijimi i kësaj pasurie është nga bashkimi i: (i) pasurisë apartament me sip. 92.29 m² dhe (ii) pasurisë shtesë anësore me sip. 65.7 m², blerë nga shtetasit T. e A. N dhe shkëmbyer me shtetasit E. dhe O. D.

42. Për këtë pasuri rezultoi se janë kryer një sërë veprimesh juridike, kontrata shitblerjeje, kontrata shkëmbimi dhe kontrata dhurimi, si më poshtë:
- a) Subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.07.2011, i ka blerë çiftit N. apartamentin nr. ***, në pall. ***, hyrja ***, kati ***, me sipërfaqe 97.88 m², me vlerë 6.851.600.
 - b) Pas rreth një muaji nga blerja e kësaj pasurie me kontratën e shkëmbimit të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 12.08.2011, subjekti i rivlerësimit e shkëmben apartamentin e blerë çiftit N. me apartamentin nr. ***, pall. ***, hyrja ***, kati ***, Tiranë, me sipërfaqe 92.29 m², me shtetasit E. dhe O. D.
Pasuria apartament, me sip. 92.29 m², është regjistruar në regjistrin hipotekor më 15.08.2011 në emër të bashkëshortëve, I. dhe Artan Broci.
 - c) Apartamenti 65.7 m² (shtesë anësore), pjesë funksionale e apartamentit ekzistues me sipërfaqe 97.88 m², u legalizua me lejen e legalizimit nr. ***, datë 30.05.2012, në emër të A. N.
 - ç) Me kontratën e dhurimit të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2014, A. N i dhuron subjektit të rivlerësimit apartamentin prej 65.7 m² (shtesë anësore në apartamentin 97.88 m²). Në nenin 6 të kontratës deklarohet se: *“Këtë pasuri ia kishin dorëzuar faktikisht palës pranuese të dhurimit që kur kishin realizuar kontratën e shitjes më datë 07.07.2011, të apartamentit me sipërfaqe 97.88 m² dhe nuk e kishin formalizuar në kontratë, pasi nuk ishte i regjistruar në atë kohë.”*
 - d) Me kontratë shkëmbimi të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 16.03.2016, prona e mësipërme (apartament 65.7 m², shtesë anësore) është shkëmbyer pa shpërblim mes familjes Broci dhe familjes D.
 - dh) Në datën 07.12.2016, prona prej 157.99 m² është regjistruar e plotë (si bashkim pasurish) në regjistrin hipotekor në emër të bashkëshortëve I. dhe Artan Broci.

43. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, është shuma prej 7.000.000 lekësh nga të ardhurat që ai ka tërhequr nga llogaria e tij në Bankën Kombëtare Tregtare (“BKT”), të përfituara nga investimi në bono thesari në vitin 2010, i shumës prej 10.000.000 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

44. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka blerë në vitin 2011 një shtëpi banimi me sipërfaqe 97.88 m² (por deklaroi se praktikisht ka blerë sip. 97.88 m² + 65.7 m²) për çmimin prej 6.851.600 lekësh, pastaj e ka shkëmbyer në vitin 2011 sipërfaqen 97.88 m² me sipërfaqen 92.29 m².
45. Shtesa prej 65.7 m² është rivlerësuar me regjistrimin e saj të parë pranë ZVRPP-së, pas legalizimit, në emër të znj. A. N, në vlerën prej 4.769.820 lekësh.
46. Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nëpërmjet kontratës së dhurimit sipërfaqen 65.7 m², të cilën e ka shkëmbyer pa shpërblim me shtetasit D. në vitin 2016, dhe ka kryer edhe regjistrimin e pronës prej 157.99 m² (të blerë në vlerën 6.851.600 lekë). Vlera e rivlerësuar e kësaj pasurie është 11.621.420 lekë.
47. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën prej 7.000.000 lekësh nga të ardhurat që ai ka tërhequr nga llogaria e tij në “BKT”, – deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, – rezultoi se:
- a) Në deklaratën “Vetting”, nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar si burim shuma e tërhequr prej 7.000.000 lekësh, sipas vërtetimit të “BKT”-së, për blerje dhe rikonstruksion apartamenti. Kjo shumë vjen nga Banka e Shqipërisë (përfituar nga investimi në bono thesari në vlerën 10.000.000 lekë, me afat maturimi 1-vjeçar. Shuma prej 10.000.000 lekësh, investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, vjen nga shitja në prill 2010 e shtëpisë në Plazh, *** - Durrës, në vlerën 102.000 euro.

- b) Në raportin e ILDKPKI-së thuhet: vërtetim nga “BKT”, datë 16 prill 2012, ku më datë 19.05.2011 Artan Broci ka pasur gjendje në shumën 9.926.981 lekë, transfertë nga Banka e Shqipërisë, fonde të Bankës së Shqipërisë. Në qershor 2011 është tërhequr shuma 7.000.000 lekë për blerje dhe rikonstruksion apartamenti.
- c) Nga verifikimi i veprimeve të subjektit të rivlerësimit në “BKT” rezultojnë: (i) tërheqje *cash* më datë 28.06.2011, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit, shuma prej 4.000.000 lekësh, me përshkrimin “Për blerje apartamenti”; (ii) shuma prej 4.926.981 lekësh është transferuar po atë datë, në llogari depozitë me afat 40-ditor; (iii) në datën 23.9.2011 është kryer tërheqja *cash* me vlerën 3.000.000 lekë, e cila është bërë pa përshkrim.

48. Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 07.07.2011, për sip. 97.88 m², me vlerën 6.851.600 lekë, thuhet se paratë janë paguar të gjitha jashtë zyrës noteriale, para lidhjes së kontratës.

49. Pas verifikimit të lëvizjeve në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë mospërputhje mes fakteve të konstatuara dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikon nëpërmjet lëvizjeve bankare pagesën e këtij apartamenti deri më datë 7 korrik 2011, në shumën prej 6.851.600 lekësh, pasi rezultoi se ai ka tërhequr vetëm 4.000.000 lekë nga “BKT”-ja, deri në datën e lidhjes së kontratës.

50. Në lidhje me pjesën e apartamentit, ndërtim pa leje/shtesë anësore prej 65.7 m², rezultojnë se:

- a) Ajo nuk është deklaruar në deklaratimet vjetore 2011 - 2014 të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në kontratën e shkëmbimit mes palëve se e ka poseduar atë që prej vitit 2011.
- b) Shtesa prej 65.7 m² është legalizuar dhe më pas regjistruar në pronësi të A. N më 25.07.2013 dhe rivlerësuar me regjistrimin e saj të parë pranë ZVRPP-së, në vlerën prej 4.769.820 lekësh. Shtesa u është dhuruar nga A. N, me konfirmim edhe të z. T. N (bashkëshorti), më 23.12.2014 shtetasve Artan dhe I. B. Pas dy vitesh, më 16.03.2016 është nënshkruar kontrata e shkëmbimit me shtetasit E. dhe O. D.

51. Sa më sipër, vihet re se dokumentacioni justifikues ligjor, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ishte i pamjaftueshëm dhe kishte deklaratime kontradiktore në lidhje me periudhën e blerjes, pagesën e kryer për blerjen e kësaj prone, posedimin dhe transferimin e pronësisë dhe të drejtave të tjera reale për shtesën anësore.

52. Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i kolegjit civil që ka marrë vendimin nr. 00-2014-1258, me nr. 11243-01783-00-2014 regjistri themeltar, më datë 22.05.2014 me paditës L. Q, palë të paditur AKKP-në dhe palë të tretë ZVRPP-në Berat dhe T. N, lidhur me një tokë të babait të tij. Kolegji civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e ankimit të veçantë të paditëses në lidhje me kompetencën.

53. Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, duket se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit për arsye të marrëdhënies së tij të posaçme me shtetasin T. N, dhurimin e apartamentit me sipërfaqe 65.7 m², kohën e realizimit të këtij dhurimi, si dhe pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit si anëtar i kolegjit civil që ka marrë vendimin nr. ***, me nr. *** regjistri themeltar, më datë 22.05.2014, me paditës L. Q, me të paditur AKKP-në dhe palë të tretë ZVRPP-në Berat dhe T. N, lidhur me një tokë të babait të këtij të fundit.

54. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzionet e hetimit për këtë pasuri

55. Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit. Ai ka sqaruar se mënyra si e ka paguar këtë apartament (ap. 97.88 m²) nuk ka qenë ajo e deklaruar në kontratë, por një mënyrë tjetër alternative, më e volitshme për subjektin e rivlerësimit, dhe e mbështetur në marrëdhënien e mirëbesimit dhe fqinjësisë prej shumë vitesh.

Subjekti i rivlerësimit në këtë periudhë ka qenë gjyqtar i Republikës së Shqipërisë dhe subjekt i deklarimit të pasurive, por nuk rezulton e shpjeguar kjo mënyrë pagese, në asnjë nga deklaratat e pasurisë dhe as në deklaratën “Vetting”.

Mbeten kontradiktore deklaratimet e subjektit për kohën dhe vlerën e likuidimit të kësaj pasurie në vlerë 6.851.600 lekë, ai nuk provoi me ndonjë dokumentacion ligjor pagesë e kryer.

56. Pasuria shtesë anësore, me sip. 65.7 m², është pretenduar se është blerë menjëherë me shtëpinë me sip. 97.88 m², por kjo nuk është deklaruar asaj kohe nga subjekti i rivlerësimit, kështu veprimet e mëpasshme të kryera nga ai kanë krijuar dyshime mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie.

57. Kontrata e dhurimit për ap. 65.7 m², nga familja Numani është realizuar më 23.12.2014, megjithëse është legalizuar në vitin 2012 dhe regjistruar në pronësi të A. N më 25.07.2013. Kontrata e dhurimit përkon me kohën në të cilën është kryer edhe procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, e cila ka ngritur dyshime për trupin gjykues.

58. Lidhur me situatën e konfliktit të interesit, në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit sqaroi se ai ka gjykuar ankimin e veçantë të palës, për të vlerësuar vetëm çështjen se cila gjykatë e shkallës së parë do të ishte kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, pa gjykuar themelin e çështjes.

59. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk bindën trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke mbetur e dyshimtë mënyra e kryerjes së pagesës për blerjen e kësaj prone qysh prej fillimit, po ashtu edhe gjendja në situatën e konfliktit të interesit.

60. Pasuria shtëpi plazhi, apartament 147 m² (papafingo), në komunën *, Durrës, shitur në vitin 2010.** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën “Vetting” si pika “3/1”, pas pronës apartament me sip. 157.99 m² në Tiranë, “pika 3”, në seksionin “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”.

61. Për arsye edhe të lidhjes mes pasurive (pasuria “shtëpia e plazhit” ka shërbyer si burim të ardhurash dhe shtim pasurie), hetimi administrativ për këtë pasuri u shtri te procedurat e kryera për blerjen dhe shitjen e kësaj pasurie, si dhe burimi i krijimit të saj. Ligjshmëria e pasurisë monetare të përfituar dhe transaksionet e kryera. Për këtë:

a) U verifikua (i) kontrata e porosisë për punime që kryen me prenotim nr. *** rep., nr. ***kol., datë 06.09.2006 dhe (ii) kontrata për prenotim dhe dorëzim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15 prill 2010, i porosituri Artan Broci dhe porositësi F. Gj (apartament i shitur në vlerën 102.000 euro).

b) U verifikua ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj pasurie, si edhe ligjshmëria e pasurisë monetare të përftuar nga shitja e kësaj prone dhe transaksioneve të kryera.

62. *Burimi i krijimit* - Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit deklaroi këtë pasuri të blerë në vlerën 55.000 euro dhe si burim krijimi të saj, pjesërisht me kursime dhe pjesërisht me kredi në Bankën Amerikane, sot “Intesa Sanpaolo”. *Me shitjen e kësaj shtëpie, në prill të vitit 2010, është bërë edhe mbyllja e kësaj kredie në qershor 2010.*

63. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka paraqitur një kontratë noteriale datë 06.09.2006 “Kontratë porosie për punime që kryhen me prenotim”, mes tij dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe administrator z. A. S kundrejt shumës 55.140 euro, prej të cilave sipas kontratës: 20 mijë euro u paguan nga subjekti i rivlerësimit në zyrën noteriale kur u lidh kontrata, kësti i dytë 15.000 euro të paguhej brenda datës 20.02.2007 dhe kësti i tretë, vlera e mbetur 20.140 euro, të paguhej më 20.09.2007.

64. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI vetëm një mandat arkëtimi nr. 36, datë 30.09.2007, të shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., për arkëtimin e shumës 15.000 euro për këtë pasuri. Në këtë faturë gjendet shënimi me dorë: “Kësti i fundit prej 20.140 eurosh zbritet dhe përfundimisht likuidohet detyrimi i ngelur 15.000 euro”. Ky mandat është firmosur nga administratori i “****” sh.p.k., z. A. S, dhe vulosur nga shoqëria.

65. Nga dokumentacioni i paraqitur dhe mandatet e arkëtimit krijohen dyshime mbi vlerën e blerjes së këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit.

66. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka shitur këtë apartament në vlerën 102.000 euro, duke paraqitur një kontratë noteriale për prenotim dhe dorëzim apartamenti, nr. *** rep., nr. ***kol., datë 15 prill 2010, i porosituri Artan Broci dhe porositësi F. Gj. Në kontratë thuhet se shuma 82.000 euro është paguar jashtë zyrës noteriale dhe shuma 20.000 euro do të paguhet deri në datën 20.12.2010.

67. Për këtë transaksion nuk është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndonjë dokument për provuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesës (përveç kontratës).

68. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 82.000 eurosh është investuar menjëherë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, duke paraqitur një faturë të datës 12.05.2010 për konvertimin e shumës 80.000 euro në lekë tek agjencia e këmbimit valutor “****” sh.p.k., si dhe dokument të datës 12.05.2010 për transferimin e shumës 10.000.000 lekë pranë Bankës së Shqipërisë për bono thesari, drejt “BKT”-së.

69. Në raportin e paraqitur nga ILDKPKI-ja, për këtë pronë ka të dhëna në faqen 6, ku vërehet se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar:

- Kontratë porosie për punime që kryhen me prenotim nr. *** rep., nr. ***kol., datë 06.09.2006, me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., me porositës Artan Broci, nga e cila vërehet porositur apartament me sipërfaqe 103 m² dhe verandë 44 m². Çmimi 55.140 euro. Në datën e lidhjes së kontratës është paguar shuma 20.000 euro; kësti i dytë, 15.000 euro, të paguhej brenda datës 20.02.2007; kësti i tretë, vlera e mbetur prej 20.140 eurosh, të paguhej më 20.09.2007.
- Mandatarkëtimi nr. 36, datë 30.9.2007, paguar shuma 15.000 euro, për “****” sh.p.k..
- Kontratë kredie bankare, datë 18.09.2007, me Bankën Amerikane, kredia e marrë në shumën 30.000 euro.
- Kontrata për prenotim dhe dorëzim apartamenti nr. *** rep., nr. ***kol., datë 15 prill 2010, i porosituri Artan Broci dhe porositësi F. Gj. Shuma 82.000 euro është paguar jashtë zyrës noteriale dhe shuma 20.000 euro do të paguhet deri në datën 20.12.2010.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.06.2010, për fshirje inskriptimi nga “ISP Bank”, lirohet nga hipoteka pasuria “zyrë” me sip. 40 m², e bllokuar për shkak të marrjes së kredisë. Me shlyerjen e kredisë, kjo pronë lirohet nga hipoteka e vendosur mbi të.
- Kërkesë për transaksion në “BKT”, datë 12.05.2010 (për të kryer transaksion për shumën 10.000.000 lekë, për pjesëmarrje në blerje bono thesari).
- Vërtetim për shpallje fituesi për bono thesari, datë emetimi 20.05.2010.

Hetimi i kryer nga Komisioni

70. *Blerja e pasurisë.* Duke qenë se nga dokumentacioni i disponuar, deklarata “Vetting” dhe deklarimet periodike ngrihen dyshime mbi vlerën e saktë të paguar për blerjen e apartamentit, iu drejtua firmës “****” sh.p.k., e cila me shkresën e datës 13.02.2018 sqaron se apartamentin ia ka shitur Artan Broci me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., më datë 06.09.2006, në vlerën 55.140 euro dhe se shoqëria i ka bërë zbritje në çmim shumën prej 5.140 eurosh, pa dhënë ndonjë arsye.

71. Shoqëria ka paraqitur bashkëlidhur shkresës edhe 3 mandate arkëtimi, të cilat evidentohen për herë të parë.

- Mandat nr. 3, datë 05.09.2006, me vlerë 20.000 euro, arkëtuar nga Artan Broci për prenotim apartamenti. Ky mandat mban vulën e noteres B. C, por në dokumentacionin e plotë të kontratës që ka paraqitur vetë noterja, me shkresën e datës 08.02.2018, ky mandat mungon.

- Mandati nr. 2, datë 03.03.2007, me vlerë 15.000 euro, arkëtuar nga *Artan & Broci*.

Në këtë mandat vihet re me sy të lirë se është zhgarravitur fjala “S”, e cila përkon me mbiemrin e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. (A. Semini) dhe është shkruar me kaligrafi dhe intensitet të ndryshëm fjala “Broci”. Ky mandat nuk është i vulosur nga shoqëria.

- Mandati i tretë, nr. 36, datë 30.09.2007, me vlerë 15.000 euro, arkëtuar nga Artan Broci. Në këtë faturë gjendet shënimi: “Kësti i fundit prej 20.140 eurosh zbritet dhe përfundimisht

likuidohet detyrimi i ngelur 15.000 euro". Ky mandat është i firmosur nga administratori i "****" sh.p.k., A. S dhe me vulë të shoqërisë.

72. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën "Vetting" ka deklaruar se ka blerë shtëpinë në plazh për vlerën 55.000 euro. Në deklarin periodik të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka blerë shtëpinë në vlerën 55.140 euro dhe se ka kryer pagesën e këstit prej 20.000 euro. Ai nuk ka deklaruar në këtë vit detyrimin e mbetur (borxhin) për këtë pasuri. Në deklarin periodik të vitit 2007, subjekti deklaroi marrjen e një kredie në datën 27.09.2007, e cila shërbeu për mbylljen e një kredie të mëparshme dhe likuidimin e shumës për shtëpinë në plazh, ***, Durrës. Ai nuk ka deklaruar pagesat e kryera, ndryshimet/detyrimet lidhur me këtë pasuri.

72.1 Nga dokumentacioni që disponohet, nuk evidentohet vlera reale që është blerë ky apartament dhe pagesat e kryera për këtë pasuri.

73. I është kërkuar noterës që ka kryer këtë kontratë një kopje e praktikës, e cila është përgjigjur në datën 08.02.2018, duke dërguar një kopje të plotë të praktikës së hartuar në zyrën e saj noteriale, por nuk ka bashkëlidhur mandati nr. 3, datë 05.09.2006, me vlerë 20.000 euro, arkëtuar nga Artan Broci, për prenotim apartamenti, i cili mban vulën e noterës B. C, dhe është paraqitur si parapagim për prenotim apartamenti.

74. Është pyetur nëpërmjet komunikimit elektronik lidhur me këtë situatë edhe subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, i cili ka deklaruar se: *"...Vlera e apartamentit është ajo e deklaruar në kontratë, pra 54.140 euro. Por, kur unë kam likuiduar këstin e fundit, prezent kanë qenë të dy ortakët e shoqërisë dhe nga z. K. më është bërë prezent se, për shkak të njohjes dhe miqësisë disavjeçare me të, kisha një zbritje nga pjesa e tij e fitimit, duke e zbritur detyrimin përfundimtar në vlerën e 15.000 eurove..."*.

...

Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë që ju shtroni, po ju deklaroj se vlera reale që unë kam paguar për këtë apartament është 50.000 euro, sipas mandateve bashkëlidhur...".

75. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar vlerën 50.000 euro për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën "Vetting" dhe as në deklarin e pasurisë ndër vite, duke deklaruar një vlerë të ndryshme nga vlera reale e paguar për këtë pasuri.

76. *Sipas analizës ekonomike:* referuar situatës financiare të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2006, si dhe të dhënave të bankave konstatohet se, për këtë vit (2006), ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë (likuidim kësti 20.000 euro), për krijimin e kursimit *cash* të deklaruar nga ai atë vit dhe për shpenzime të tjera, konkretisht:

Analiza/ Periudha 31.12.2006		
Zëri	Vlera	Vlera
Pasuri të paluajtshme (shtesë)	6.192.500	
Likuiditete (gj. fund-fillim)	667.882	
Total pasuri	6.860.382	
Detyrime		3.715.500
Pagesë kësti kredi	423.630	
Total detyrime		3.715.500
Të ardhura		2.728.981
Shpenzime të tjera, udhëtime, pushime	78.645	
Shpenzime mes. për jetesë	975.000	
	8.337.657	6.444.481
Shtesë pasuri dhe shpenzime të pambuluara nga të ardhurat		-1.893.176

*Shënim: Në tabelë nuk janë përfshirë disa të ardhura të deklaruara nga qiradhënia, për të cilat nuk rezultoi të jetë paguar tatim përkatës mbi të ardhurat (referuar shkresës nr. ***prot., datë 20.03.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shkresës nr. ***prot., datë 27.01.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë), duke u konsideruar si të ardhura jo të ligjshme referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

77. Nga kërkimet e bëra në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se më 19.06.2014 subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k. (nr. *** regjistri themeltar/ nr. *** i vendimit ***). Gjykata ka vendosur të rrëzojë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, që e detyron firmën “****” sh.p.k. të paguajë 391.260 euro për dëmin që u ka shkaktuar paditësve.

78. Për arsye të marrëdhënies që subjekti i rivlerësimit kishte me shtetasit A. S dhe firmën “****” sh.p.k., si dhe miqësisë së hershme që ai kishte me ortakët e saj, ai duhet të kishte kërkuar dorëheqjen në bazë të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” nga kjo çështje gjyqësore.

79. *Shitja e pasurisë*. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka paraqitur një kontratë “Për prenotim dhe dorëzim apartamenti” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2010, me të porositur subjektin e rivlerësimit dhe porositës shtetasin F. Gj (pa praninë e firmës ndërtuese si palë në këtë kontratë, ndërkohë që kjo pronë nuk ishte ende e regjistruar në regjistrat hipotekorë) për apartamentin 147 m² (papafingo) në komunën ***, për vlerën 102.000 euro, nga të cilat në kontratë është shkruar se 82.000 euro janë paguar jashtë zyrës së noterisë dhe 20.000 euro do të paguhen deri më 20.12.2010.

80. Në pikën 4 të kontratës, “Detyrimet e palës porositëse”, thuhet se: “4. *Deklaroj se jam dakord që pagimi i tatimit mbi të ardhurat e përfutuara nga shitja e këtij apartamenti është në ngarkimin tim...*”.

80.1 Në pikën 4, “Detyrimet e të porositurit”, citohet: “4. *Realizimi i kontratës së shitblerjes do të bëhet midis nesh në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të dokumenteve ligjore që do përgatis unë për pronësinë e apartamentit në ZVRPP Durrës në emrin tim, sipas ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*”.

80.2 Në pikën 5 të kontratës citohet: “5. *Deklaroj se jam dakord që pagimi i tatimit mbi të ardhurat e përfutuara nga shitja e këtij apartamenti është në ngarkimin tim*”.

81. Me regjistrimin e kësaj prone në regjistrin hipotekor nga shoqëria ndërtimore, kalimi i pronësisë do të bëhej në emër të z. Broci dhe se ai do të bënte kalimin e të drejtës së pronësisë tek z. Gj, duke paguar edhe tatimin mbi të ardhurat e fituara nga shitja.

82. Për këtë pronë u kërkuar informacion edhe nga ZVRPP Durrës².

82.1 Në shkresën kthim përgjigje nga ZVRPP-ja Durrës³, rezulton se pasuria nr. ***vol. ***, fq. *** ZK***, është regjistruar në emër të shtetasve F. Gj e K. Gj në bazë të kontratës së shitblerjes së apartamentit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.12.2016, me palë shitëse “****” sh.p.k. dhe palë blerëse F. Gj, për shumën 102.000 euro. Bashkëlidhur kontratës ishin edhe mandatet e arkëtimit: nr. 25, datë 15.04.2010, te shoqëria “****” sh.p.k., për vlerën 82.000 euro; dhe nr. 29, datë 20.12.2010, te shoqëria “****” sh.p.k., për vlerën 20.000 euro.

82.2 Bashkëlidhur, ZVRPP-ja Durrës dërgon edhe kontratën e porosisë me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj, përpiluar *pa noter*, më datë 15.04.2010.

83. Vërehet se shitja e apartamentit i është referuar kontratës së porosisë me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj, përpiluar më datë 15.04.2010, duke u anashkaluar tërësisht kontrata me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 15.04.2010, mes shtetasve F.Gj dhe Artan Broci. Mandatet e pagesës që shoqërojnë kontratën e shitblerjes mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit F. Gj janë të firmosura nga administratori i shoqërisë dhe të vulosura nga shoqëria.

84. Në kontratën e shitjes mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Gj, pa prezencën e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., citohet se: “*Realizimi i kontratës së shitblerjes do të bëhet midis nesh në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të dokumenteve ligjore që do të përgatis unë për pronësinë e apartamentit në ZVRPP Durrës, në emrin tim, sipas ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.”*, por rezulton se z. Gj e ka regjistruar këtë pronë në regjistrin hipotekor

² Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018.

³ Shkresën nr. *** prot., datë 27.02.2018.

mbështetur në kontratën e porosisë dhe më pas, atë të shitblerjes, të lidhur me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., duke paguar vetëm taksën nga ndërtuesi te blerësi i parë.

85. Po ashtu, mbetet i pavërtetuar edhe fakti se si janë marrë këto para, duke qenë se kemi, nga një anë, deklarin për marrjen e parave nga z. Broci (por pa asnjë dokument provues) dhe, nga ana tjetër, mandatet e firmës “****” sh.p.k. për arkëtimin e kësaj shume.

86. Në datën 6 mars është pyetur subjekti i rivlerësimit për këtë transaksion. Ai shpjegon: “Në vitin 2010, pra mbas 4 vitesh që e posedonim këtë apartament, pati një rritje të kërkesave për apartamente në zonën e plazhit, kryesisht shtetas nga Kosova, por dhe të vendeve nordike. Duke qenë se nevojat tona si familje po rriteshin me rritjen e fëmijëve tanë, vendosëm ta shisnim apartamentin në fjalë dhe midis disa blerësve shfaqti interes z. F. Gj.

Me z. Gj kam njohje që nga viti 1991-1992, nëse nuk gaboj.

Më duhet të sqaroj se në vitin 2010, në Republikën e Shqipërisë transaksionet lejoheshin në kesh (cash) dhe unë vlerën e kontratës e kam marrë në dorë (cash). Me marrjen e këstit të parë prej 82.000 eurosh, për të cilat nuk ishte e ndaluar mbajtja e tyre në banesë në vitin 2010, unë jam paraqitur pranë një agjencie këmbimi valutator më datë 12.05.2010 dhe kam bërë konvertimin e shumës prej 80.000 eurosh në vlerën e 10.896.000 lekëve dhe, po në këtë datë, pra më 12.05.2010, kam depozituar shumën prej 10.000.000 lekësh pranë bankës “BKT” dhe më datë 20.05.2010 janë investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë me maturim 1-vjeçar. Bashkëlidhur keni kopje të mandateve.”

87. Subjekti ka bashkëlidhur një faturë të datës 12.05.2010 për konvertimin e vlerës prej 80.000 eurosh në lekë tek agjencia e këmbimit valutator “****” sh.p.k., si dhe dokument të datës 12.05.2010 për transferimin e shumës 10.000.000 lekë pranë Bankës së Shqipërisë për bono thesari, drejt “BKT”-së, gjë e cila provon investimin në bono thesari të vlerës së pretenduar, por nuk provon kryerjen e transaksioneve të shitblerjes së pasurisë mes z. Broci dhe z. Gj.

88. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kontratës së shitjes së apartamentit ka përfituar të ardhura në vlerën 52.000 euro (102.000 euro - 50.000 euro, nëse do të jetë kjo vlera reale e blerjes së pasurisë) dhe rezulton se nuk janë shlyer detyrimet tatimore përkatëse nga z. Broci, megjithëse palët kanë pranuar në kontratën e shitblerjes mes tyre të shlyejnë këtë detyrim.

89. Lidhur me pagimin e tatimit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “...Në rastin konkret, unë nuk jam bërë asnjëherë pronar me dokument hipotekor mbasi shoqëria në vitin 2006, kur unë kreu porosinë, nuk kishte bërë regjistrimin e pallatit në ZRPP dhe, gjithashtu, nuk ishte bërë as në vitin 2010, kur unë i transferova të drejtat mbi apartamentin te z. Gj.

Kontrata ime me z. Gj, në vitin 2010, është një kontratë e shitjes së të drejtave reale, e lejuar nga ligji, pasi nuk kisha vërtetim pronësie për të cilat edhe sot neni 8 i ligjit për tatimin mbi të ardhurat nuk e parashikon si detyrim ligjor për t’u paguar.”

90. Nga hetimi rezultoi se për këtë apartament ka dy kontrata më datë 15.04.2010 me shtetasin F. Gj, një mes tij dhe firmës “****” dhe një mes tij dhe z. Artan Broci.

91. Nga hetimi rezultoi se referuar të dhënave në QKB (nga faqja zyrtare) në datën 07.06.2010 është miratuar aplikimi i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, për pezullim aktiviteti, i cili ka zgjatur deri më datë 02.08.2011. Në kohën që është kryer transaksioni i dytë në cash (vlera prej 20.000 eurosh) shoqëria ka qenë me status të pezulluar nga QKB-ja.

92. Nga hetimi rezulton se ka deklarime kontradiktore, që nuk vërtetojnë saktësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me blerjen e kësaj pasurie, shitjen e saj, deklarin e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, burimin e ligjshëm të pasurisë financiare.

93. Nga situata e krijuar, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, është thirrur për të dëshmuar edhe shtetasi F. Gj. Ai ka deklaruar se shtëpinë ia ka blerë z. Artan Broci⁴. Z. F. Gj ka shpjeguar se lekët ia ka dhënë z. Broci sipas kontratës dhe jo firmës “****” sh.p.k. Ai ka deklaruar gjithashtu se me z. Broci kanë miqësi të ngushta familjare. Z. F. Gj ka deklaruar se ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së dhe se e ka deklaruar këtë pasuri.

⁴ Për më shumë, shiko deklaratën në dosje.

94. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve, iu kërkua ILDKPKI-së kopje e deklarimeve periodike për vitet 2009 dhe 2010 të z. F. Gj. ILDKPKI-ja dërgon me shkresën e datës 13.04.2018 përgjigjen se z. F. Gj, në vitin 2010 nuk ka qenë më subjekt deklarimi, duke dërguar bashkëlidhur edhe Deklaratën e Interesave Private “Pas largimit nga funksioni 2009”.

95. Nga hetimi rezulton se firma “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit Artan Broci dhe shtetasi F. Gj kanë lidhur kontrata fiktive, duke krijuar një situatë jo të qartë juridike mbi vlefshmërinë e kontratave, po ashtu edhe pagimin e çmimit të shitjes.

96. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka blerë apartamentin nga shoqëria “*****” sh.p.k. për vlerën 55.140 euro, por në të vërtetë ka paguar më pak, duke bërë deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë të pasurisë në deklaratën “Vetting”.

97. Nëpërmjet dokumentacionit të administruar, nuk mund të provohet marrja nga subjekti i rivlerësimit i shumës prej 102.000 euro, nga shtetasi F. Gj, shumë të cilën më pas ai e ka përdorur për krijimin e pasurive të tjera.

98. Nëpërmjet veprimeve fiktive të kryera dhe konfuzionit të krijuar nga kontratat mes palëve “****” sh.p.k., z. Artan Broci dhe z. F. Gj, është shmangur edhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga Artan Broci nga shitja e apartamentit.

99. Sipas analizës ekonomike, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme në vitin 2006 për të paguar këstin e parë të prenotimit të banesës. Edhe pagesa e dy kësteve të tjera nuk rrezulton e qartë. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë bindshëm ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe të pasurisë së krijuar.

100. Për këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit, si dhe gjithë problematikën e hasur, iu kërkua mendim Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si autoritet qendror përgjegjës për konfliktin e interesit dhe për vlerësimin e pasurisë, sipas Deklaratës së Interesave Private.

101. Pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës për këtë pasuri: (i) kontrata datë 06.09.2006 dhe 3 mandatet e arkëtimit; (ii) kontrata noteriale datë 15.4.2010 dhe faktin se kësti i parë prej 80.000 eurosh është paguar jashtë zyrës noteriale, para lidhjes së kësaj kontrate dhe kësti prej 20.000 eurosh do të paguhej deri më datë 20.12.2010; (iii) dokumentacionin e sjellë nga ZRPPP-ja Durrës për regjistrimin e pronës (kontratë prenotimi, kontratë shitjeje dhe 2 mandate arkëtimi me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasin F. Gj), – ILDKPKI-ja shprehet se:

“... Rezultojnë 2 kontrata të ndryshme, të lidhura në të njëjtën datë, 15.04.2010, për këtë apartament banimi.

...

Lidhur me pagimin e vlerës së parashikuar në kontratë mes z. Broci dhe z. Gj, në kushtet kur pagesa e këstit të parë është paguar jashtë zyrës noteriale, midis palëve, është e paqartë mënyra e përfitimit të kësaj pagese nga z. Artan Broci, po ashtu dhe për këstin e dytë nuk ka të dhëna në çfarë forme është bërë kalimi i shumës, duke krijuar dyshime për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e këtyre veprimeve.

...

*Lidhur me pagimin e vlerës së parashikuar në kontratë mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit F. Gj, rezultojnë dy mandate pagese me vulën e shoqërisë, paguar nga shtetasi F. Gj në favor të shoqërisë.*

...

*Kemi dy kontrata, nëpërmjet të cilave kalohen të drejta reale mbi një pasuri të paluajjtshme, por si kalues të këtyre të drejtave shfaqen dy subjekte të ndryshme, z. Artan Broci dhe shoqëria “****” sh.p.k. Mbajtës i kësaj të drejte reale ka qenë vetëm njëri prej tyre, sepse sipas të drejtës civile nuk mund të jenë mbajtës njëkohësisht të së njëjtës së drejtë dy subjekte të së drejtës civile, përveçse kur e kanë fituar atë bashkërisht, pra janë bashkëpronarë, duke krijuar kështu dyshime për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e këtyre kontratave.”*

102. Lidhur me konfliktin e interesit, ILDKPKI-ja shprehet se: *“Duke analizuar të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur nga ana juaj, në lidhje me situatën e konfliktit të interesit të referuar nga Komisioni dhe analizës që ILDKPKI-ja bën, rezulton e provuar që z. Artan Broci,*

gjqtar i Gjykatës së Lartë, në lidhje me këtë vendimmarrje ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesave dhe të papajtueshmërisë së funksionit publik.”.

103. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzionet e hetimit për këtë pasuri

104. Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

105. Në vlerësim të tyre rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting” dhe në ato ndër vite, lidhur me pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti. Nga hetimi rezulton se ai ka paguar paratë *cash*, një herë para noterit dhe dy herë në arkën e shoqërisë dhe për këtë ai ka paraqitur mandatet e arkëtimit, nga të cilat njëri është me korrigjime dhe pa vulë.

Subjekti ka kryer deklaram të rrem lidhur me vlerën reale me të cilën ai ka blerë apartamentin tek shoqëria “***” sh.p.k..

106. Lidhur me pamundësinë financiare për të paguar këstin e parë prej 20.000 euro, të konstatuar nga analiza ekonomike, në të cilën nuk ishin përfshirë disa të ardhurat nga qiratë pasi rezultonte se nuk ishin paguar detyrimet tatimore, sipas shkresave të ardhura në Komision nga Drejtoria e Tatim-Taksave Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, pas sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe provave të paraqitura prej tij për pagimin e detyrimeve tatimore, përkatësisht sipas rastit, trupi gjykues i pranoi ato duke i rillogaritur të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

107. Duke qenë se informacionet që kërkohen u përkasin periudhave 10 apo 15 vjet më parë, ku edhe administrimi i dokumentacionit nga drejtoritë rajonale tatimore nuk rezulton i plotë, referuar edhe faktit se flasim për tatim mbi qiratë, i cili shpesh paguhej edhe nëpër posta dhe nuk ka ekzistuar sistemi elektronik i hedhjes së të dhënave, duket i vështirë verifikimi i saktësisë së informacionit të ardhur nga Drejtoria e Tatim-Taksave. Mosrakordimet që u vunë re në të dhëna që vijnë nga institucionet tatimore dhe ato të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, të marra po nga institucionet tatimore (por nga personi i interesuar) besohet se vijnë nga vështirësia në gjetjen e tyre dhe shpesh nga mungesa apo miradministrimi i të dhënave për tatimin mbi qiranë, mbase edhe për vetë nivelin e të ardhurave të ulëta që ato përfaqësojnë.

108. Në këtë rast, është e nevojshme që vetë subjekti të paraqesë kontratat dhe tatimin që është paguar respektivisht, për të provuar se pasuria e tij është e ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës (detyrim kushtetues për procesin e rivlerësimit).

109. Mbi bazën e të dhënave që u administruan nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të dhënave që u paraqiten nga subjekti i rivlerësimit trupi gjykues, duke përdorur metodën logjike dhe vlerësimin me objektivitet të provave dhe shpjegimeve të paraqitura, i pranoi ato si të sakta.

110. Pas analizës financiare, duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të mbështetura dhe me dokumentacion justifikues ligjor për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja (përfshirë kursimet *cash* më datë 31.12.2006 të marra gjendje) dhe treguesit financiarë të subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, rezultoi kjo analizë financiare krahasuese:

Analiza financiare për vitin 2006	Sipas Komisionit	Sipas subjektit të rivlerësimit në prapësime	Sipas Komisionit pas prapësimeve
	2006	2006	2006
Të ardhurat neto nga pagat dhe noteria	2.728.981	2.728.981	2.728.981
Të ardhurat neto qiradhënie, dyqan, Shallvare	0	1.080.000	900.000
Të ardhurat neto qiradhënie, zyra	0	342.000	0
Të ardhurat neto qiradhënie, shtëpi, Shkodër	0	334.395	0
Total të ardhura	2.728.981	4.485.376	3.628.981

Pagesat për shpenzime	1.477.275	1.460.955	1.477.275
Ndryshim mj.monetare gj. fillim-gj. fund periudhe	-667.882	936.000	-667.882
Mjete monetare të disponueshme	583.824	3.960.421	1.483.824
Pagesa për blerje pasurie: Apartament, Durrës	6.192.500	6.192.500	6.192.500
Detyrime	3.715.500	3.715.500	3.715.500
Pasuri neto	2.477.000	2.477.000	2.477.000
Balanca e fondeve	-1.893.176	1.483.421	-993.176

111. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit përsëri nuk ka arritur të justifikojë me të ardhura të vërtetuara, pagesat, shpenzimet, si dhe kursimet e krijuara në vitin 2006. Në rastin kur vlera prej 1.700.000 lekësh, e deklaruar kursime *cash* në deklarin periodik të vitit 2006, vlerësohet si shtesë nga viti i kaluar dhe jo gjendje *cash* në banesë, atëherë pamjaftueshmëria financiare për këtë vit do të shtohet edhe me 1.200.000 lekë të tjerë.

112. Lidhur me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e kontratave (kontratë porosie për punime që kryhen me prenotim, kontrata për prenotim dhe dorëzim apartamenti, kontratën e porosisë me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj, përpiluar pa noter), subjekti sqaroi se nuk ka pasur dijeni për ekzistencën e kontratës së porosisë me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj, përpiluar pa noter, dhe se ka besuar se në kontratën e shitjes përfundimtare të lidhur midis palëve “****” sh.p.k. dhe z. F. Gj është cituar kontrata e shitjes së të drejtave reale ndërmjet palëve Artan Broci dhe F. Gj.

113. Sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi kualifikimin drejt të marrëdhënies juridike midis palëve në rastin konkret janë të sakta. Kur i referohemi kontratës së dytë që ne disponojmë, të lidhur në vitin 2010 ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. F. Gj, e cila nuk është hartuar në formën e aktit noterial, por është hartuar me shkresë të thjeshtë, duket se kontrata mes shoqërisë “****” sh.p.k dhe Artan Brocit ka vlerë më të plotë juridike. Kontrata e porosisë lidhur mes firmës “****” dhe porositësit F.Gj duket fiktive.

114. Për sa i takon kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, ajo nuk mund të bëhet mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe blerësit F. Gj, pasi firma e ndërtimit “****” sh.p.k., ia kish shitur me “Kontratë porosie për punime që kryhen me prenotim” në datë 06.09.2006, porositës Artan Broci, ndaj ajo duhet të bëhet me shtetasin Artan Broci (siç edhe parashikohej në kontratën e vitit 2010) dhe më tej, me pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja, nga z. Broci, ajo do të kalonte në emër të z. F. Gj.

115. Ndërkohë, rezulton se kontrata për prenotim dhe dorëzim apartamenti mes shtetasve Artan Broci dhe F. Gj është shmangur tërësisht, duke lidhur një kontratë porosie me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj dhe, më tej, kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme mes shoqërisë “****” dhe shtetasit F.Gj, përkundrejt vlerës së përcaktuar në mandatet e pagesës në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k.

116. Fakti se kjo shoqëri ka qenë në status pasiv në periudhën e pagesës së kështit të dytë, në vlerën 20.000 euro, krijon bindjen gjithashtu se disa nga veprimet mes shoqërisë “****” dhe blerësit F. Gj kanë qenë fiktive, duke shmangur edhe pagimin e tatimit mbi fitimin për të ardhurat e përfituara nga shitja të subjektit të rivlerësimit.

117. Neni 83 i Kodit Civil i referohet kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me anë të së cilës kalon edhe e drejta reale mbi sendin dhe ka si kusht të vlefshmërisë aktin noterial dhe regjistrimin në hipotekë, por jo detyrimisht edhe kontratave të porosisë apo të sipërmarrjes mes palëve. Edhe hipoteka e ka pranuar kontratën e porosisë me palë premtuese “****” sh.p.k. dhe palë porositëse F. Gj, pa noter, e cila paraprinte kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme mes tyre.

118. Nga shpjegimet e dhëna, provat e paraqitura dhe dokumentacioni i administruar në dosjen e rivlerësimit, trupi gjykues krijoi bindjen se apartamentin në fjalë, shtetasi F. Gj e ka blerë te shtetasi Artan Broci, por më tej, veprimet e kryera për kalimin e të drejtës së pronësisë tek zoti Gj. kanë sjellë për pasojë shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja, për subjektin e rivlerësimit.

119. Lidhur me paraqitjen e ndonjë dokumentacioni justifikues ligjor që provon marrjen e vlerës prej 102.000 euro, (në dy këste) dhe kohën e likuidimit, trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

Çështja juridike dhe logjike që do të mund të shtrohet në rastin konkret është nëse pagesat e çmimit të shitjes së sendit të paluajtshëm duhet të provohen vetëm me shkresë apo mund të pranohet dhe lejohet edhe prova me dëshmitar, dhe sa vlerë provuese ka dëshmia, a është ajo e mjaftueshme për të vërtetuar faktin objekt prove, në rastin konkret pagesat e çmimit të shitjes.

120. Dëshmia e z. F. Gj u pranua nga Komisioni. Me anë të saj provohej se shtetasi F. Gj e ka blerë këtë pasuri fillimisht nga shtetasi Artan Broci, duke deklaruar gjithashtu se këtë shumë ia ka paguar atij, pa sqaruar për mënyrën e kryerjes së kësaj pagese.

121. Sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe prova e re e paraqitur⁵ nuk sollën ndonjë konkluzion të ndryshëm nga rezultatet e hetimit, pasi përsëri mbeti e paprovuar mënyra e përfitimit të pagesës prej 82.000 eurosh, si dhe koha dhe mënyra e likuidimit të kështit të dytë prej 20.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit.

122. Referuar çmimit të lartë të shitjes së këtij apartamenti, miqësisë së vjetër mes z. Broci dhe z. Gj (të deklaruar nga palët) dhe veprimeve fiktive të kryera për këtë pasuri mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. Gj, trupi gjykues nuk u bind nga sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, për pagesën e vlerës së apartamentit, ndaj z. Broci, për kështin e parë dhe të dytë të saj.

123. Raportimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmojnë lidhur me kontratën noteriale të lidhur mes z. Broci dhe z. Gj, por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me pagimin e shumës. Po ashtu, ato flasin për transaksione bankare për derdhjen e lekëve *cash* në llogari nga shtetasi Artan Broci, si dhe blerjen e bonove të thesarit nga ai, por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me mënyrën e qarkullimit të parave nga blerësi te shitësi.

124. Por, duke qenë se veprimi juridik është kryer në vitin 2010, duhet sqaruar se nuk ka pasur një rregullim specifik për lëvizjet monetare midis personave fizikë për shitblerje apartamenti te noteri, po ashtu nuk ka pasur ndonjë kufizim tjetër ligjor për kryerjen e pagesave *cash* midis individëve. Veprimi juridik i shitblerjes, kryer midis dy individëve, që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, nuk mbart detyrimin ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar. Ky detyrim ekzistonte vetëm për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare dhe kjo për efekt të deklarimit të tatimit, ndaj nuk mund të thuhet se pagesa *cash* ka qenë e paligjshme apo e kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

125. Por, për arsye të vlerës së madhe monetare, si dhe të gjitha rrethanave të çështjes, të paraqitura më sipër në këtë vendim, sqarimet e subjektit të rivlerësimit nuk paraqitën asnjë element që të provonte transaksionin e kryer mes z. Broci dhe z. Gj, e të bindin trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit.

126. Lidhur me situatën e konfliktit të interesit për arsye të marrëdhënies së posaçme që lidh subjektin e rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se marrëdhënia juridike mes atij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. ka përfunduar që prej një kohe shumë të gjatë, konkretisht që prej 7-8 vitesh. Marrëdhënia juridike mes palëve është përmbushur dhe se ata nuk kanë pasur më detyrime mes tyre. Zbritja e përfituar në likuidimin e faturës së fundit, që është me pak se 10 % e shumës së përgjithshme, është një *zbritje* që shoqëritë ndërtime

⁵ Deklaratën noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 17.04.2018 të deklaruesve, z. A. S, përfaqësues i shoqërisë ” ****”, z. F. Gj dhe z. Artan Broci në përmbajtjen e së cilës rezulton se shuma e shitjes prej 102.000 eurosh në vitin 2010 është përfituar prej z. Artan Broci dhe jo nga shoqëria “****” (shih deklaratën noteriale).

përgjithësisht, edhe për shkak të likuiditeteve, u bëjnë blerësve. Që prej atij momenti, nuk ka pasur më as lidhje juridike dhe as lidhje të tjera me këtë shoqëri, të tilla që ta bëjnë të jetë i interesuar në çështjet ku kjo shoqëri është palë.

127. Çështja e cituar është regjistruar për herë të parë në Gjykatën e Lartë në vitin 2010, është pezulluar ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 18.06.2010 të kolegjit civil të asaj kohe, është kaluar në dhomë këshillimi me vendimin e datës 11.01.2013 nga kolegji civil i asaj kohe, mbi bazën e relacionit të përgatitur që në atë kohë, ku janë evidentuar shkeljet e ligjit.

128. Z. Broci është emëruar si anëtar i Gjykatës së Lartë më datë 26.04.2013 dhe ka filluar detyrën më datë 01.05.2013.

129. Vendimi nr. ***, datë 19.6.2014, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, që lidh subjektin e rivlerësimit me çështjen e konfliktit të interesit, ka pasqyruar gjetjet e dhomës së këshillimit të janarit 2013⁶. Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë me shumicë votash (4 pro dhe 1 kundër), ku gjyqtari Broci është pjesë e shumicës. Vendimi ka vendosur: “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues...”.

130. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në mbështetje të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim...3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve...”.

131. Në përfundim, (i) duke vlerësuar se konflikti i interesit është gjendja e konfliktit mes detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, i cili duhet të kryejë në mënyrë të drejtë detyrat dhe me përgjegjësi, (ii) nisur nga rrethanat e çështjes dhe problematikat e hasura në lidhje me pasurinë në fjalë, të shpjeguara më lart në vendim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kish dhënë dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore, duke u vetëpërgjashuar paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës, e duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes.

132. Bono thesari, shuma 10.000.000 lekë, me afat 1-vjeçar, në vitin 2010.

133. Investuar në vitin 2010 shuma prej 100.000.000 lekësh në bono thesari. *Burimi i krijimit:* të ardhura të krijuara nga shitja e shtëpisë së plazhit, në ***, Durrës, në vlerën 102.000 euro (82.000 euro dhe 20.000 euro).

134. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara; të paraqesë dokumentacion provues ligjor (i) se ai ka marrë vlerën prej 82.000.000 euro, të konvertuara më tej në vlerën 100.000.000 lekë dhe se (ii) ato para konsiderohen pasuri e ligjshme në kuptim të pikës 3⁷ të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

135. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁸.

Konkluzionet e hetimit për këtë pasuri

136. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave, ka paraqitur si provë kontratën noteriale për prenotim dhe dorëzim apartamenti; dëshmia e z. F. Gj, dhënë përpara Komisionit; deklaratën noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 17.04.2018 të deklaruesve A. S, përfaqësues i shoqërisë “****”, z. F. Gj dhe z. Artan Broci, në përmbajtjen e së cilës rezulton se shuma e shitjes prej 102.000 eurosh në vitin 2010 është përfituar prej z. Artan Broci.

⁶ Shih vendimin dhe relacionin përkatës.

⁷ “3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.”

⁸Nëse subjekti i rivlerësimit përpigjet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

137. Subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument bankar mbi transaksionin e kryer apo gjendjen e këtyre parave në bankë nga blerësi. Ai paraqiti si provë të re vetëm deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.04.2018 të deklaruesve A. S, përfaqësues i shoqërisë “****”, z. F. Gj dhe z. Artan Broci, në përmbajtjen e së cilës rezulton se shuma e shitjes prej 102.000 eurosh në vitin 2010 është përfituar prej z. Artan Broci. Kjo deklaratë vjen në vijim të dyshimeve të ngritura, pas evidentimit të mandateve të pagesës ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., por siç edhe shpjegoam më lart, trupi gjykues u bind se marrëdhënia e shitblerjes së apartamentit është kryer mes shtetasit F. Gj dhe subjektit të rivlerësimit, por nuk ka mundur të provohet në ndonjë mënyrë bindëse se vlera prej 102.000 euro i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, Artan Broci.

138. Lidhur me pagimin e tatimit për të ardhura shtesë të përfituara nga shitja e apartamentit, nga dokumentacioni i administruar në dosje, si dhe shpjegimet e subjektit, *nuk rezultoi* që të jetë paguar tatim për fitimin mbi të ardhura.

139. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nuk parashikohet as sot një agjent tatimor për derdhjen e tatimit për kontratat e shitjes së të drejtave reale, por udhëzimi i mësipërm përcakton detyrime vetëm për pasuritë e regjistruara pranë ZRPP-ve dhe për kontrata shitjeje kur pasuritë janë të regjistruara rregullisht, duke përcaktuar si agjent tatimor zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

140. Duke analizuar veprimet e kryera lidhur me shitjen e pasurisë⁹, e cila ka krijuar këto të ardhura, duket se nëpërmjet tyre është shmangur edhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat e përfituara për vlerën 52.000 euro, nga shitja e pasurisë.

141. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit dhe të provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka arritur të shmangë pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë, të cilat kanë shërbyer si burim për pasuri të mëvonshme.

142. Pasuria zyrë 40 m² + 11.5 m², me adresë blv. “**”, Tiranë,** blerë me kontratë shitblerjeje më datë 28.02.2003, për vlerën 45.000 USD.

143. *Burimi i krijimit:* pjesërisht me kursime 21.000 USD dhe pjesërisht me kredi nga Banka Amerikane në vlerën 24.000 USD. Kjo kredi është mbyllur në vitin 2007, me një kredi tjetër që është përdorur pjesërisht për të mbyllur këtë borxh dhe pjesërisht për të paguar shtëpinë e plazhit, në ***, Durrës.

144. Në kontratën e shitblerjes të datës 28.02.2003, me objekt shitjen e një ambienti zyre me sipërfaqe 40 m² + 11,5 m², në Bulevardin “****”, Tiranë, me çmim shitjeje 45.000 USD, është *deklaruar e marrë e gjithë shuma menjëherë, jashtë zyrës noteriale.*

145. Kontrata e kredisë bankare i përket datës 24.06.2003 në Bankën Amerikane, për shumën 24.000 USD. Kredia është disbursuar më datë 26.06.2003 në vlerën 24.000 USD dhe më datë 27.06.2003 është tërhequr *cash* shuma 23.298 USD, pa përshkrim destinacioni.

Hetimi i kryer nga Komisioni

146. Për blerjen e pasurisë zyrë në Bulevardin “****”, Tiranë, nuk përputhen deklarimi te noteri më datë 28.02.2003 për shlyerjen plotësisht të të gjithë shumës menjëherë, si dhe deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” për burim e blerjes së kësaj zyre.

147. Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 15.02.2018, rezulton se kredia është disbursuar afro 4 muaj pas likuidimit të vlerës për blerjen e zyrës. Shuma e tërhequr nga banka, *cash*, është më e vonë se data e blerjes së kësaj prone nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk është i provuar destinacioni i saj.

148. Nga analiza ekonomike e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij, rezultoi se ai nuk ka pasur aftësi pagueuse për likuidimin e vlerës prej 45.000 USD më datë 28.02.2003, kur është bërë likuidimi i vlerës për blerjen e kësaj zyre. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të kursejë vlerën prej 21.000 USD, deri

⁹ Marrëdhënie e analizuar më lart te pasuria shtëpia e plazhit, ***, Durrës.

në datën 28.02.2003 (duke përfshirë vetëm të ardhurat për të cilat kishim konfirmuar derdhjen e detyrimeve tatimore).

149. Lidhur me likuidimin e kredisë në dollarë, likuiduar në vitin 2007 nga një kredi tjetër në euro, referuar shkresës datë 15.02.2018 të “Intesa Sanpaolo Bank”, rezultoi se kredia në euro është disbursuar më datë 27.09.2007 dhe më datë 28.09.2007 është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit vlera prej 23.265 euro. Më datë 27.09.2007 është kaluar me transfertë të brendshme me konvertim shuma prej 2.815.91 euro në llogarinë në dollarë, e konvertuar me 3.970 USD.

150. Subjekti i rivlerësimit, më datë 27.09.2007, ka bërë derdhje *cash* 11.000 USD në llogarinë nr. *** në “Intesa Sanpaolo Bank”, duke mbyllur kredinë e marrë më datë 24.06.2003. Derdhja *cash* e shumës prej 11.000 USD për mbyllje kredie është një ditë përpara tërheqjes *cash* të disbursimit të kredisë tjetër në euro më datë 28.09.2007 në vlerën 23.265 euro.

151. Vlera prej 11.000 USD depozituar përpara tërheqjes së kredisë, janë të ardhura të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nisur nga fakti se edhe objekti i kredisë ka qenë për shlyerjen e kredisë paraardhëse dhe pjesa tjetër për likuidimin e pjesës së mbetur të shoqërisë “****” sh.p.k. (blerje apartamenti).

152. Më datë 31.12.2007 nuk janë deklaruar gjendje 2.140 euro në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” nr. **, të subjektit të rivlerësimit, si dhe shuma prej 2.991 eurosh në llogarinë e bashkëshortes në “BKT”.

153. Kjo pasuri zyrë në Bulevardin “****”, Tiranë, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është dhënë me qira. Këtë çështje do ta trajtojmë më poshtë, në kreun “Hetimi administrativ mbi pasuritë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur”.

154. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzione të hetimit lidhur me këtë pasuri

155. Lidhur me pamundësinë financiare për të justifikuar pagimin e vlerës prej 21.000 USD për blerjen e pasurisë, pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave të subjektit të rivlerësimit, për pagimin e detyrimeve tatimore, trupi gjykues i pranoi ato. Megjithëse kishte mospërputhje në të dhënat e paraqitura sipas shkresave të ardhura në Komision nga Drejtoria rajonale e Tatim-Taksave Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave dhe të dhënave të paraqitura nga personi i interesuar, trupi gjykues pranoi dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me logjikën e përdorur edhe më lart në këtë vendim.

156. Mbetet e paprovuar mënyra se si është kryer pagesa e kësaj kontrate, më datë 28.02.2003, kur është bërë likuidimi i vlerës për blerjen e kësaj zyre, pasi rezultojnë se të gjitha tërheqjet nga banka janë kryer pas datës 28.02.2003 që është lidhur kontrata, përkatësisht në datat 24.06.2003 në Bankën Amerikane, për shumën 24.000 USD dhe më datë 27.06.2003, tërhequr *cash* shuma 23.298 USD, pa përshkrim destinacioni.

157. Mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe kontratën e shitblerjes së kësaj prone, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë pronë në datën 28.02.2003, të deklaruar në kontratë.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore, ato nuk mundën të provojnë të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë çështje.

158. Lidhur me derdhjen *cash* të vlerës 11.000 USD për mbyllje kredie më datë 27.09.2007, mosdeklarim të gjendjes prej 2.140 eurosh, në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank”, nr. **, të subjektit të rivlerësimit, si dhe shumën prej 2.991 eurosh në llogarinë e bashkëshortes në “BKT”, pas sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provave të paraqitura prej tij, trupi gjykues i konsideron ato të plota, duke e quajtur të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këto çështje.

159. Prona shtëpi përdhese, në adresën Rr. “**”, Shkodër, me sipërfaqe ndërtese 90 m² dhe truall 396 m² (bashkëpronar).**

Ndërtesa përfituar nga privatizimi, më datë 11.04.1994, nga Enti i Banesave, në vlerë 20.370 lekë, në emër të pjesëtareve të familjes, H., L., D. (A. dhe I. B. Më pas L. B, më datë 31.08.2005, ia shet pjesën e saj (1/4) H. B (bashkëpronarë mbeten H., A. dhe I. B).

Më datë 25.03.2010, Bashkia Shkodër u shet bashkëpronarëve 100 m² truall. Më pas, me vendim nr. ***, datë 26.07.2012, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, bashkëpronarët përfitojnë edhe 296 m² truall (si oborri i kësaj shtëpie).

Trualli i përfituar ka kushtuar: sip. trualli prej 100 m², për vlerën 1.391.824 lekë, paguar më datë 25.03.2010, sip. trualli prej 296 m², për vlerën 400.000 lekë, paguar më datë 26.07.2012.

160. Rezulton se sipërfaqja e truallit prej 296 m² (oborri) nuk është deklaruar gjatë deklaramëve periodike 2012 - 2016, ndërsa në deklaratën “Vetting” është deklaruar totali i sipërfaqes së truallit/oborri prej 396 m², me çmimin e blerjes së parë, në vlerën 1.391.824 lekë.

161. Në deklaratën “Vetting” deklarohen të ardhura nga qiraja e kësaj pasurie për periudhën 2000 - 2011 në vlerën 36.000 euro. Këtë çështje do ta trajtojmë më poshtë, në kreun “Hetimi administrativ mbi pasuritë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur”.

162. Më datë 17.04.2016, subjekti i rivlerësimit lidh një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k. për ndërtimin e një vile 2 kate + 1 kat nën çati, në vlerën 1.500.000 lekë. Në kontratë (nenin 6, pika “k”) parashikohet se: “Pala sipërmarrëse do të realizojë punimet sipas projektit me mjetet, pajisjet, punëtorët, lejet, licencat, materialet ... etj., të saj”. Subjekti rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë vlerë si detyrim të pashlyer.

163. Subjekti i rivlerësimit vetëdeklaroi në deklaratën “Vetting” se për ndërtimin e kësaj banese ka marrë si dhuratë materiale ndërtimi, si hekur, çimento, tulla, pasqyruar në faturat tatimore:

- Nr. 21, datë 05.01.2017, lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., me vlerë me TVSH 1.022.736 lekë, me shënimin “Dhuratë për ndërtim shtëpie”;

- Nr. 22, datë 05.01.2017, lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., me vlerë me TVSH 140.640 lekë, me shënimin “Dhuratë për ndërtim shtëpie”.

Transporti i materialeve të ndërtimit sipas këtyre dy faturave tatimore është kryer me mjetet e shoqërisë “****” sh.a.

Hetimi i kryer nga Komisioni

164. Në pyetësin që i dërgohet subjektit të rivlerësimit, në fillim të procesit të rivlerësimit, ai ka deklaruar: “2/2. Në janar të vitit 2017 më është dhuruar një sasi hekuri, tulla, etj. materiale ndërtimi nga shoqëria “****” për ndërtimin e shtëpisë në Shkodër sipas faturave nr.21 dhe nr.22, datë 05.01.2017, në vlerën 1.163.376,00 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë. Këto mallra, materiale ndërtimi të pasqyruara në këto fatura megjithatë kanë qenë dhuratë, nuk janë pranuar prej meje dhe mbas disa insistimeve të herëpashershme, në muajin shtator 2017, janë likuiduar shuma e mësipërme me xhirim bankar nga llogaria e bashkëshortes sime tek llogaria e shoqërisë “****” sh.a.

E bëj këtë sqarim pasi ky është deklarim që i përket periudhës ushtrimore datë 01.01.2017 - 31.12.2017, i cili pasqyrohet në deklarin e pasurisë që dorëzohet pranë ILDKPKI-së deri me 31 mars të vitit 2018.”.

165. Nga shqyrtimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se më datë 13.07.2012, subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë që ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë paditëse shoqërinë “****” sh.a., me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin E. Gj. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur (nr. *** vendimi, nr. *** regjistri themeltar) pranimin e kërkesëpadisë nga “****” sh.a., kundër Agjencisë së Prokurimeve Publike me objekt: Anulimin tërësisht të vendimit nr. ***, datë 25.05.2011, të Agjencisë së Prokurimeve Publike: “Për përjashtimin nga prokurimet publike të shoqërisë “****” sh.a., për një periudhë trevjeçare”.

166. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzionet e hetimit lidhur me këtë pasuri

167. Lidhur me mospërputhjen mes deklarimit periodik dhe deklarimit në deklaratën “Vetting” për këtë pasuri (sipërfaqen e truallit prej 296 m², për vlerën 400.000 lekë), shpjegimet e subjektit të rivlerësimit u dukën bindëse dhe vërehet se arsyeja e mosdeklarimit nuk ka qenë e qëllimshme. Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

168. Lidhur me situatën e konfliktit të interesit, e cila rezultoi nga hetimi, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe provat e paraqitura shpjegojnë se miqësia e z. Artan Broci me z. E. Gj ka filluar pas viteve 2014, për shkak të një rrethane e cila krijoi marrëdhënie private/miqësore mes tyre dhe se në kohën e gjykimit të çështjes, në vitin 2012, kur subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues, ai nuk ka pasur njohje me z. E. Gj, apo me shoqërinë “****” sh.a.

169. Subjekti i rivlerësimit ka provuar se ka shlyer këtë detyrim në vitin 2017.

170. Në dokumentacionin e dërguar nga ILDKPKI-ja, mungonte dokumentacioni lidhur me blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz” ***, me targë ***, blerë në vitin 2013, në vlerën prej 1.000.000 lekësh, vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

171. U administrua kopje e plotë e automjetit me targë *** nga DRSHTRR-ja Tiranë dhe përputhet me të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

172. U verifikuan emri i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm dhe nuk rezultoi që z. Artan Broci apo familjarët e tij të kenë në pronësi apo përdorim ndonjë automjet tjetër të regjistruar në emër të tyre.

173. Hetimit administrativ iu nënshtrua pasuria monetare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

174. U kontrolluan llogaritë bankare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, konkretisht:

- a) Kontratë individuale-tip anëtarësimi në “Fondin e pensionit vullnetar”, në emër të *subjektit të rivlerësimit*, më datë 17.05.2016, me shoqërinë “SICRED”.
- b) Bono thesari (obligacione) pranë “Credins Bank”, në emër të *subjektit të rivlerësimit*, të blera në vitin 2015.
- c) Bono thesari pranë “BKT”, në emër të *subjektit të rivlerësimit*, të blera në maj të vitit 2015.
- ç) Gjendje e llogarisë pranë “BKT”, e *subjektit të rivlerësimit*, për pagesë qiraje për zyrën te blv. “****”.
- d) Gjendje llogarie pranë “Credins Bank”, e *subjektit të rivlerësimit* (paga, pagesa nga dhoma e avokatisë, interesa të obligacioneve, honorarë si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë)
- dh) Gjendje llogarie “Depozita Plus” pranë “Credins Bank”, në emër të *subjektit të rivlerësimit*, burimi paga.
- e) Gjendje e llogarisë karta “Visa Classic”, pranë “Credins Bank”, në emër të *subjektit të rivlerësimit*, burimi paga.
- ë) Gjendje e llogarisë në “BKT”, e *bashkëshortes*, burimi të ardhura nga aktiviteti si notere.
- f) Gjendje e llogarisë në “BKT”, e *bashkëshortes*, burimi të ardhura nga aktiviteti si notere.
- g) Të ardhura neto nga interesat e depozitave pranë “BKT” në emër të bashkëshortes.
- gj) Gjendje e llogarisë individuale pranë “BKT”, e fëmijës së mitur.
- h) Gjendje e llogarisë individuale pranë “BKT”, e fëmijës së mitur.
- i) Gjendje e llogarisë si person fizik, pranë “BKT”, e bashkëshortes, të çelur si llogari për aktivitetin noterial për klientë.
- j) Gjendje e llogarisë individuale pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, e fëmijës madhor, burimi nga paga.
- k) Gjendje e llogarisë si person fizik, pranë “BKT”, i fëmijës madhor, burimi të ardhura nga aktiviteti.

175. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto të ardhura:

- a) Të ardhura nga paga nga viti 1993 e deri sot, të ardhura si honorarë, si anëtar i KLD-së, dhe të ardhura nga pagesa si anëtar i komitetit disiplinor të DHKA-së, si përfaqësues i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- b) Të ardhura nga qiratë, (i) zyrë në blv. “***”, (ii) dyqani te “****”, (iii) shtëpi private në Shkodër.

176. Lidhur me burimin e të ardhurave nga pagat dhe pagesa të tjera, burimi i të ardhurave është i justifikuar dhe mbështetet në transaksione të ligjshme, të deklaruara dhe të provuara.

177. Lidhur me burimin e të ardhurave nga qiratë, sipas germës “b)”, vërehet se në deklaratimet periodike subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhura nga qiraja konkretisht:

Periudha	Shtëpi Shkodër	***	Blv. “****”	
2003		1.080.000		
2004	380.220	1.200.000		
2005	367.620	1.200.000	712.380	
2006	371.550	1.200.000	338.904	
2007	365.340	1.200.000	360.000	
2008	371.400	1.200.000	840.000	
2009	413.880	1.200.000	840.000	
2010	416.310	1.200.000	840.000	
2011	416.790	1.200.000	840.000	
2012		1.102.524	840000	
2013		1.514.268	840.000	
2014		1.513.512	840.000	
2015		1.482.624	840.000	
2016		1.460.484	840.000	
Totali	3.103.110	17.753.412	8.971.284	29.827.806

(i) Shtëpia në Shkodër.

178. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaron se ua ka dhënë këtë shtëpi me qira nga viti 2000 - 2011 shoqatave të ndryshme të huaja dhe individëve për vlerën 250 euro në muaj. Ai deklaron të ardhura nga qiraja e kësaj pasurie për periudhën 2000 - 2011 në vlerë 36.000 euro.

179. Referuar deklaratimit për herë të parë, më datë 06.02.2004, subjekti i rivlerësimit nuk deklaron të ardhura nga qiradhënia e shtëpisë në Shkodër, ndërsa në deklaratimet periodike të të ardhurave, kjo qiradhënie fillon të pasqyrohet në deklaratimin për vitin 2004 e deri në vitin 2011.

180. Shuma e dekluar në deklaratimet periodike si të ardhura nga qiraja e kësaj pasurie është në vlerën 3.103.110 lekë, për periudhën 2004 - 2011.

181. Për dhënien me qira të kësaj pasurie, subjekti ka vënë në dispozicion vetëm një kontratë, e përpiluar më datë 20.11.2007, me afat 1 vit, me vlerë 250 euro/muaj, dhënë një individ, pa shpjegime për periudhat e tjera.

182. Nga deklaratimet periodike, rezulton se subjekti i rivlerësimit i deklaron të ardhurat e përfituara pa zbritur tatimin mbi këto të ardhura.

183. Në rast se qiramarrësi që paguan shumën e qirasë është individ, bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, detyrimin për deklaratimin e të ardhurave të siguruara nga qiradhënia dhe pagesën e tatimit e ka vetë qiradhënësi, person fizik (individ).

184. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me shkresën nr. ***prot., datë 20.03.2018, ka konfirmuar se shtetasja H. B nuk është e regjistruar pranë kësaj drejtorie si individ privat.

185. Detyrimi tatimor nga qiradhënia e shtëpisë në Shkodër (2004 - 2011) është në vlerën 310.311 lekë, dhe shuma neto që duhej deklaruar referuar të dhënave të deklaruara nga subjekti duhet të ishte 2.792.799 lekë (nëse tatimi për vlerën 310.311 lekë, do të ishte paguar), e cila nuk përputhet me vlerën prej 36.000 euro deklaruar në deklaratën “Vetting” për vitet (2000 - 2011).

186. Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të vetëdeklaruara nga qiradhënia e shtëpisë në Shkodër në vlerën bruto 3.103.110 lekë (2004 - 2011), deklaruar në deklaratimet periodike, apo për vlerën prej 36.000 euro të deklaruar në deklaratën “Vetting” për vitet 2000 - 2011, duke mos treguar kështu burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie monetare.

(ii) Marrëdhënia e qirasë për ambientin zyrë në Bulevardin “****”, Tiranë.

187. Sipas deklaratës “Vetting” të subjektit të rivlerësimit, të ardhurat nga kjo pasuri janë përdorur si burim të ardhurash në formën e qiradhënies, duke filluar që nga viti 2005. Shuma e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit ka qenë në vlerën 7.600.500 lekë.

188. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kontratë qiraje të datës 02.11.2005, midis tij (subjektit të rivlerësimit) dhe personit fizik L.O (qiramarrësi), regjistruar me NIPT ***, me objekt: Dhënie me qira të zyrës në blv. “****”, me një afat 3-vjeçar, 01.10.2005 - 01.10.2008, çmimi në 6 muajt e parë është në vlerën 25.000 lekë/muaj dhe më pas, në vlerën 35.000 lekë në muaj.

189. Për këtë qiradhënie, në komunikimin elektronik, subjekti i rivlerësimit shprehet se:

“... Disponoj një kontratë qiraje me z. L. O për objektin: “Zyrë te ****” të vitit 2005 me afat 3 vjeçar deri në vitin 2008, kjo kontratë është zgjatur me heshtje sipas Kodit Civil deri në vitin 2014 ...”

190. Referuar deklaratimit periodik për vitin 2014, të subjektit të rivlerësimit, z. L. O e ka mbajtur zyrën deri në prill 2014.

Qiraja e deklaruar për periudhën 2008 - 2014 ka qenë në vlerën 70.000 lekë në muaj (mungon kontrata).

191. Referuar shkresës nr. *** prot., datë 02.02.2018, të DPTTV-së Bashkia Tiranë, më datë 01.01.2009 është lidhur një kontratë qiraje me qiramarrës R. K, J. B dhe E. H për objektin në Blv. “****”, për periudhën 01.01.2009 - 01.01.2012, me vlerë 30.000 lekë/muaj.

192. Nga hetimi rezultojnë të dhëna kontradiktore.

Për periudhën 2009 - 2012, në rastin e kontratës së dorëzuar në DPTTV-në Bashkia Tiranë (vitet 2009 - 2011), qiraja në kontratë ka qenë në vlerën 30.000 lekë në muaj. Sipas deklaratimit periodik të këtyre viteve nga subjekti të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e kësaj zyre kanë qenë në vlerën 70.000 lekë në muaj dhe sipas komunikimit elektronik me subjektin e rivlerësimit, kontratat janë shtyrë në heshtje për këtë periudhë nga shkresa nr. ***prot., datë 15.05.2018, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, nuk rezulton tatim mbi të ardhurat nga qiraja, i paguar

193. Për periudhën maj 2014 - shkurt 2016, për këtë ambient është lidhur një kontratë qiraje me personin fizik S. M, regjistruar me NIPT ***. Ndërsa nga data 11.03.2016 e në vazhdim me znj. A. Z, regjistruar me NIPT ***, në vlerë 70.000 lekë në muaj.

194. Për këtë zyrë tatimi mbi qiranë, i paguar për periudhën 2005 - 2016, sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.01.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, është në vlerën 440.631 lekë, kundrejt një detyrimi referuar vlerave të deklaruara të subjektit, në shumën prej 981.128 lekësh.

195. Nga hetimi rezulton të mos jetë paguar i plotë detyrimi përkatës tatimor, për të ardhurat e përfituara sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit.

196. Ka mospërputhje në vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerave të deklaruara në kontratën e qirasë. Po ashtu, ka mospërputhje mes deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhëna të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave Vendore Bashkia Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë monetare.

(iii) Ambient, me sip. 63m² tek “***”.

197. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se këtë pasuri e ka dhënë me qira nga viti 1996 e në vazhdim dhe të ardhurat e përfituara janë në vlerën 15.660.000 lekë dhe 41.805 euro.

198. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investime apo përmirësime për këtë pasuri, as në deklaratimet periodike, as në deklaratën “Vetting” dhe as në pyetëtorin e dërguar nga Komisioni me fillimin e procesit të rivlerësimit. Ky ambient është blerë në vitin 1996 dhe sot rezulton një ambient luksoz.

199. Për periudhën 2006 - 2011, nuk janë vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit kontratat e qirasë apo dokumentacion ligjor që provon ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara.

200. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet komunikimit elektronik, është shprehur se:

*“... Kam gjetur dhe 2 kontrata që kam pasur me shtetasin E. R për vitet 2003 dhe 2004 për objektin te “***”. Kontratat janë zgjatur me heshtje sipas Kodit Civil. Kam mandate për pagimin e tatimit 10 %, të periudhës prill 2004 - 2005, me subjektin E. R, si dhe janar - qershor 2012, pasi nga qershori 2012 e në vazhdim këtë ambient e ka me qira shoqëria “***” ...”.*

201. Për periudhën 2006 - 2011 (periudhë në të cilën mungon kontrata) është deklaruar një e ardhur në vlerën prej 7.200.000 lekë.

202. Për periudhën 2003 - 2014, referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, nga qiradhënia e kësaj pasurie janë realizuar të ardhura në vlerë 14.810.304 lekë. Tatimi mbi qiranë që duhej të paguhej, referuar këtyre të ardhurave, duhej të ishte në vlerën 1.481.030 lekë. Tatimi i paguar, referuar shkresës nr. *** prot., datë 27.01.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, të depozituara pranë ILDKPKI-së, ka qenë në vlerën 291.000 lekë dhe shuma e papaguar në vlerën 1.190.030 lekë. Të ardhura të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat rezultoi se nuk është paguar tatim, janë në vlerën 11.900.304 lekë.

203. Për periudhën 2015 - 2016, referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, nga qiradhënia e kësaj pasurie janë realizuar të ardhura në vlerë 2.943.108 lekë. Tatimi i llogaritur (15 %) për këto të ardhura është në vlerën prej 441.466 lekësh dhe shuma e likuiduar është në vlerën 567.232 lekë, me një shtesë në vlerën prej 125.766 lekë. Ka mospërputhje në të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, me tatimin e paguar për këtë periudhë. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit është bërë në lekë dhe qiraja ka qenë në euro (ndikim edhe kursi i këmbimit).

204. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

205. Për të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar (qiraja), deri në vitet 2011, nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur dokumentacion i plotë provues për krijimin e këtyre të ardhurave, si kontratat mbi qiradhënien e pasurive, dokumentacion ligjor provues mbi marrjen e pagesave nga qiratë, apo dokumentacion ligjor provues mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat. Në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, ai referon vlerën bruto të të ardhurave.

206. Pas vitit 2012, kontratat e qirave janë të plota dhe të administruara në dosje. Në këto kontrata është shprehur se tatimi mbi të ardhurat do të paguhet nga personi juridik qiramarrës.

207. U kërkua një opinion nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tatimeve, si dhe Ministria e Financave, lidhur me detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit ndër vite. Në përgjigjen e datës 14.05.2018, shpjegohet se detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie, apo kryen pagesa të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.

Duke qenë se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ka ndryshuar, edhe procedura, llogaritja, mënyra e deklarimit dhe e pagesës së tatimit ka ndryshuar.

1. Për periudhën janar 1999 deri më 2001, të ardhurat e siguruara nga qiradhënia duhet të deklaroheshin nga vetë përfituesi i të ardhurave. Pagesa bëhej sipas shumave të përcaktuara në kontratë.
2. Për periudhën 2002 e në vijim, kemi dy momente:
 - 2.1 Kur qiramarrësi është individ, është vetë individi përfitues i të ardhurave nga qiraja që duhet të deklarohet dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, nga viti 2004 deri në vitin 2012, individi përfitues i të ardhurave nga qiraja, apo nga çdo burim tjetër, për të cilat nuk ishte paguar tatimi në burim, duhet t’i deklaronte këto të ardhura në organin tatimor jo më vonë se 30 janari i vitit pasardhës.
 - 2.2 Kur qiramarrësi është person juridik, ortakëri, person fizik, rezident tatimor në Shqipëri, organi i qeverisjes qendrore apo vendore, OJF-të, ENT-të dhe që bën pagesë të qirasë, mban në burim tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor, si një tatim përfundimtar dhe, në këtë mënyrë, individi qiradhënës nuk ka detyrim që të dorëzojë deklaratën tatimore.

Sjellim në vëmendje se në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, (i ndryshuar), në pikën 5.5 “Evidentimi i tatimit të mbajtur në burim”, përcaktohet se: Tatimi i mbajtur në burim evidentohet nëpërmjet regjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilat përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për personat përfitues, ... personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat sipas përcaktimeve të nenit 33, të ligjit, duhet t’ia vënë ato në dispozicion administratës tatimore dhe personave përfitues të të ardhurave, për të cilat është bërë pagesa, kur një gjë e tillë kërkohet.

208. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën e pasurisë, duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

209. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

Konkluzionet e hetimit lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruar

210. Lidhur me pagimin e tatimit për të ardhurat nga qiraja për shtëpinë në Shkodër, subjekti rivlerësimit deklaroi se kjo banesë është përdorur nga nëna e tij, e cila është autorizuar nga bashkëpronarët për ta dhënë atë me qira. Duke sqaruar se ajo shtëpi u është dhënë me qira gjatë viteve shoqatave të huaja që operonin në Shqipëri, por dhe për shkak të kohës së gjatë, moshës së thyer të nënës dhe për faktin që banesa e vjetër është rikonstruktuar e gjitha, nuk i disponon këto kontrata.

211. Subjekti rivlerësimit, për të vërtetuar këtë fakt, ka paraqitur prokurën e posaçme, lëshuar prej nënës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.05.1999, te notere Sh. Sh, dhe polica sigurimi pranë shoqërisë “****” sh. a., për këtë banesë, në emrin e znj. H. B, për vitet 1999 - 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, duke arsyetuar se shoqatat e huaja që merrnin banesën me qira e kishin kusht sigurimin e banesës. Ai paraqiti edhe një kontratë që dispononte me shtetasin N. B, për vitin 2001, si dhe një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.07.2018, lëshuar nga z. J. B, i biri i N., i cili thotë se ata kanë jetuar si familje me qira, në banesën private të znj. H. B në Shkodër, nga viti 2007 deri në vitin 2011, duke paguar qira mujore me vlerën 250 euro në muaj.

212. Subjekti shpjegoi se mosdisponimi i mandatpagesës së tatimit vjen si rezultat i faktit se ka kaluar një kohë e gjatë por edhe mbështetur në detyrimin ligjor për ruajtjen në kohë, por se kjo nuk do të thotë se të ardhurat janë të paligjshme apo se nuk kanë ekzistuar. Ai shpjegoi gjithashtu se nuk i ka ruajtur këto mandate edhe për faktin se detyrimi për ruajtjen e tyre shkon deri në 5 vjet.

213. Edhe nga zyra postare Shkodër, pas kërkesës për informacion të bërë nga znj. H. B, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të marrë ndonjë konfirmim për pagesat e kryera të tatimeve,

pasi, bazuar në ligjin nr. 1954, datë 06.11.2003, “Për arkivat” dhe në shkresën e Drejtorisë së Postës Shqiptare, sh.a., me nr. ***, datë 31.12.2015, “Lista me afatet e ruajtjes së dokumenteve administrative të postës shqiptare”, përcaktohet si 5 vjet afati i ruajtjes së mandateve respektive sipas shërbimeve dhe anekseve përkatëse. Në zbatim të afatit të përcaktuar, dokumentacioni për periudhën e kërkuar nuk është më në ruajtje në arkivin e postës. Duke paraqitur për këtë çështje edhe provat përkatëse, të cilat u administruan në dosje.

214. Mbështetur në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016, i cili ka parashikuar se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.”*

215. Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër është kthyer përgjigje Komisionit, por ajo nuk konfirmon pagesën e tatimit për qiranë për këtë individ. Nisur nga koha e largët, besohet se këto të dhëna vijnë nga vështirësia në gjetjen e tyre dhe shpesh mungesa apo miradministrimi i të dhënave për tatimin mbi qiranë, i cili shpesh paguhej edhe nëpër posta, dhe se nuk ka ekzistuar sistemi elektronik i hedhjes së të dhënave.

216. Në rast kur drejtoria përkatëse e tatimeve nuk konfirmon pagesën e kryer të tatimit, është e nevojshme që vetë subjekti të paraqesë kontratat dhe dokumente që tatimi është paguar respektivisht, për të provuar se pasuria e tij është e ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës (detyrim kushtetues për procesin e rivlerësimit).

217. Mbështetur në sqarimet e subjektit të rivlerësimit, mbi pamundësinë e tij për të dokumentuar pagesën e tatimit, dokumenteve të paraqitura prej tij për qiratë, si dhe informacioneve të marra nga Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Shkodër, trupi gjykues, duke përdorur metodën logjike dhe vlerësimin me objektivitet të provave dhe shpjegimeve të paraqitura, çmon se të ardhurat kanë qenë nga qiratë, por nuk u provua ligjshmëria e tyre sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

218. Lidhur me pagimin e tatimit për të ardhurat nga qiraja për pasuritë: **ambient, me sip. 63 m², te “***”; ambient në blv. “***”**, subjekti rivlerësimit sqaroi se marrëdhënien e qirasë (si veprim juridik joformal) mund ta provojë edhe me dëshmitarë, referuar dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë. Po ashtu, ai sqaroi se marrëdhënien e qirasë ndër vite (kryesisht vitet 2004 - 2011) e vërteton me deklaratat noteriale të qiramarrësve, duke i paraqitur ato si provë e re.

219. Për sa më sipër, në kuadër të parimit të lirisë kontraktore dhe lirisë së formës së veprimit juridik, fakti i ekzistencës së këtyre kontratave provohet si nga dëshmia e qiramarrësve, ashtu dhe kontratat bashkëlidhur. Duke qenë se ekzistojë kontrata, por ato më tej janë përsëritur me gojë dhe vetë subjektet qiramarrëse e pranojnë këtë nëpërmjet deklaratave, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit duken bindëse.

220. Lidhur me ambientin te “***”, subjekti deklaroi se ka zhvillime dhe prova të reja në drejtim të tatimit në burim, si dhe kontrata dore të lidhura mes tij dhe ish-qiramarrësve të ndodhura në dosjet e tyre respektive, të cilat për shkak të kohës së gjatë, nuk janë mbajtur mend nga ana e subjektit. Ai ka deklaruar se kontratat janë zgjatur me heshtje, duke na i vënë në dispozicion ato.

221. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për disa raste kontratat përkatëse, si dhe dokumente të pagimit të tatimit, të cilat ka sqaruar se i ka marrë nga vetë qiramarrësit, pas përpjekjeve të shumta nga ai për marrjen e këtij informacioni nga Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Tiranë.

222. Ai ka paraqitur si provë të re shkresën nr. *** prot., datë 05.07.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, kthim përgjigje, z. L. O, klinikë dentare me NIPT ***, si dhe shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatim-Taksave Tiranë me nr. *** prot., datë 05.07.2018, drejtuar z. E. R, “***”, me NIPT ***, nga ku rezultojnë të ardhura të ndryshme nga ato që po e njëjta drejtori i ka dërguar Komisionit.

223. Duke qenë se lidhur me këto të ardhura dhe pagimin e tatimit, gjendemi përpara faktit se informacioni i ardhur nga Drejtoria e Tatim-Taksave Tiranë dhe ai i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen, mbështetur në arsyetimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe arsyetimi i ndjekur edhe më lart mbi administrimin e të dhënave nga drejtoritë përkatëse të tatim-taksave, trupi gjykues, duke përdorur metodën logjike dhe vlerësimin me objektivitet të provave dhe shpjegimeve të paraqitura, çmon se të ardhurat kanë qenë nga qiratë, por nuk u arriti të provohej ligjshmëria e të gjitha të ardhurave të krijuara ndër vite sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

224. Lidhur me investimin në ambientin të “***”, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përmirësimet e sendit janë kryer nga vete qiramarrësit, duke paraqitur si provë edhe një deklaratë me nr. *** prot., datë 2.07.2018, të lëshuar nga shoqëria “***” (qiramarrësi), e cila është administruar në dosje.

225. Të ardhurat e bashkëshortes janë kryesisht nga veprimtaria e saj si notere dhe të ardhura të përfituara nga interesat bankare dhe investimi në bono thesari. Për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti, ka mospërputhje të vlerave të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore me të dhënat e ardhura nga Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Tiranë.

226. Referuar deklaratimeve periodike mbi të ardhurat dhe të dhënave me shkresën nr. ***prot., datë 06.03.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, me të cilën janë dërguar të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga periudha 2003 deri në vitin 2016, nga aktiviteti “Noteri”, regjistruar me NIPT ***, – rezulton se për periudhën 2003 - 2006 (referuar shkresës së sipërpërmendur) të ardhurat janë qarkullim - tatimin e paguar. Për vitin 2007 është marrë deklarimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave Vendore të Bashkisë Tiranë, ndërsa për periudhën 2008 - 2016 është paraqitur fitimi neto i deklaruar pas tatimit.

227. Në lidhje me llogaritë bankare, bashkëshortja ka kryer transaksione bankare nga disa llogari bankare, të krijuara në emër të saj individual dhe që lidhen me aktivitetin si notere.

228. Në lidhje me udhëtimet. Mbështetur në të dhënat e sistemit TIMS, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka udhëtuar jashtë vendit 58 herë, nga data 01.06.2004 deri më 19.01.2018, nga të cilat 8 udhëtime kanë qenë për motive pune. Po ashtu, janë evidentuar edhe udhëtimet e bashkëshortes dhe fëmijëve.

229. I pyetur në pyetësin dërguar subjektit të rivlerësimit, ai ka deklaruar: “2. A keni marrë ndonjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro apo ka financuar dikush një shpenzim për llogarinë tuaj në një shifër më të lartë se kjo shumë në shtatë vitet e fundit (respektivisht 2011 - 2017)? Nëse po, ju lutem specifikoni se cili ishte burimi i kësaj dhurate ose pagese dhe cila ishte shuma.

2/1. Dhuratë të drejtpërdrejtë mbi këtë shumë nuk kam marrë, por më duhet të sqaroj se 2 - 3 vitet e fundit jam ftuar me familjen në udhëtime turistike nga vjehri i djalit tim, shtetasi L .H. së bashku me familjen e tij, ku besoj se vlera e mësipërme ka kaluar, por për shkak të marrëdhënieve të posaçme. Nuk e di saktësisht shumën e shpenzuar prej tij.”

230. Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka pasur të ardhura për të përballuar shpenzimet për udhëtime.

231. I pyetur për shkollimin e fëmijëve të tij, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka sqaruar se të tre fëmijët janë shkolluar në kolegjin “***”, duke deklaruar edhe shpenzimet.

232. Është pyetur institucioni arsimor “***”, dhe ka sqaruar se të tre fëmijët e z. Artan Broci janë shkolluar me tarifë zero lekë, duke u konsideruar nxënës me bursë, dhënë me vendim të këshillit drejtues të shkollës, bazuar në politikat e brendshme të institucionit. Ata kanë paguar përkatësisht vetëm tarifë transporti për vajzën A. B., për 2 (dy) vjet; tarifë transporti, uniforme dhe libra, për dy fëmijët I. B. dhe I. B., për 2 (dy) vite, nga 4.

233. Hetimi administrativ kryesisht, i kryer nga Komisioni, u shtri edhe më tej nga ai pasurive të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit.

234. U kërkua informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të

Paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ujësjellës-Kanalizim Tiranë. Gjatë këtij verifikimi, Komisioni është vënë përpara fakteve, si më poshtë.

235. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit disponon shtesë anësore, ndërtim pa leje, në fazë legalizimi. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.07.2017, nga ALUIZNI drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar, më datë 23.01.2015, një shtesë anësore pa leje, me adresë në katin e parë të pallatit nr. ***, Rr. “****”, me sipërfaqe dhe vlerë të padeklaruar.

236. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar asnjëherë këtë objekt në Deklaratën e Interesave Private Periodike/Vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”.

237. U pyet ILDKPKI-ja lidhur me detyrimin për deklarim të ndërtimeve informale të palegalizuara apo në proces legalizimi. Në përgjigjen e saj, të datës 25.05.2018, ajo sqaron se: “... objekt i deklarimit të pasurive dhe burimit të krijimit të tyre, në deklaratën e interesave private ‘Para fillimit të detyrës’ janë: të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, ... të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.”. ILDKPKI-ja shprehet se: “Është detyrim ligjor i subjekteve deklaruuese për deklarimin e çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të drejta të tjera reale mbi to, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, sipas ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar.”.

238. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

239. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se prona është një ndërtim provizor. Ai sqaron mbështetur në një interpretim të specializuar nga ALUIZNI, se kjo pronë është *ndërtuar me konstruksion të lehtësuar metalik, në vijë anësore me apartamentin ekzistues, rrethim me parapet 90 cm, kangjella dekorative dhe mbulesë xhami (plexiglass)*. Në këto kushte, kjo lloj strukture nuk mund të konsiderohet ndërtim pa leje. Duke sqaruar kështu edhe arsyet e mosdeklarimit të kësaj prone që ai posedon dhe duke paraqitur bashkëlidhur edhe shkresën nr. *** prot., datë 10.07.2018, “Kthim përgjigje”, nga Drejtoria e ALUIZNI-t “Tirana-2”.

240. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit u dukën bindëse për trupin gjykues lidhur me ndërtimin, por duke qenë se ai ka kryer këtë ndërtim me konstruksion të lehtë, por njëkohësisht ka zënë një sipërfaqe toke të cilën e përdor, ai duhet të kish deklaruar posedimin e kësaj prone.

241. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit¹⁰, z. Artan Broci, ka një kontratë me OSHEE-në si abonent familjar me status aktiv, për një apartament në adresën: “**”, Tirana 2, kompleksi “****”, hapur më datë 29.11.2007 dhe me status aktiv, si dhe një kontratë me UKT-në¹¹, po në emër të z. Artan Broci, e regjistruar në sistemin e menaxhimit të informacionit për apartamentin në “****”, kategoria familjar, data e hapjes 30.11.2006. Regjistrimi është bërë me letërnjoftim. Më datë 10.01.2014 është vendosur matës i ri dhe nuk ka ndryshim të dhënash. Statusi: kontratë aktive.**

242. Pas verifikimit që u bë lidhur me kontratën e OSHEE-së, rezulton se ajo është hapur më datë 29.11.2007 dhe është aktive. Faturat janë paguar rregullisht dhe ato kanë qenë me konsumim. U kërkua nga OSHEE-ja kontrata dhe dokumentacioni mbështetës për këtë kontratë dhe rezultoi se personi që administron këtë banesë nuk ka qenë në banesë ditën kur punonjësi i OSHEE-së ka shkuar për të përditësuar të dhënat (15.03.2017).

243. Për këtë kontratë është bërë përditësimi i të dhënave nëpërmjet sistemit *online* me kompjuter (më datë 14.01.2018). Në të dhënat e përditësuara është vendosur numri i kontratës, emri, atësia, mbiemri dhe numri personal, të cilat janë të njëjtat me ato në kohën e regjistrimit të kontratës dhe korrespondojnë me ato të subjektit të rivlerësimit.

244. Nga verifikimi që bëme në zyrat e Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë, rezultoi se në muajin nëntor 2006 ishte depozituar nga shoqëria ndërtuese lista e banorëve të pallatit dhe numrat e kontratave respektive, ku numrit rendor “23” i korrespondon shtetasit Artan Broci. Gjithashtu, faturat mujore rezultojnë me konsumim dhe të paguara rregullisht.

¹⁰ Shkresë datë 06.2.2018, nga OSHEE-ja.

¹¹ Shkresë datë 20.4.2018, nga UKT-ja.

245. Për këtë fakt të ri u pyet shoqëria “****” sh.p.k., lidhur me kontrata të mundshme me shtetasin Artan Broci, në kompleksin “****”, e cila u përgjigj se nuk ka asnjë kontratë me këtë subjekt.

246. U pyet noterja E. K, me cilësinë e noteres që ka lidhur kryesisht kontratat e sipërmarrjes në këtë kompleks, e cila u përgjigj se pranë zyrës së saj nuk rezulton e lidhur ndonjë kontratë me z. Artan Broci.

247. U verifikua në regjistrin e gjendjes civile dhe rezultoi se është vetëm një shtetas me emrin Artan B. Broci.

248. Nga hetimi u konstatua një pasuri e padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, e mbajtura nga persona të tjerë. Për këtë fakt, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.

249. Subjekti rivlerësimit shpjegoi se ai nuk ka asnjë kontratë tjetër të lidhur, përveç asaj të banesës që ai ka në pronësi në Rr. “****”, nr. ***, Tiranë. Ai sqaroi se nga komunikimi që ka pasur me shoqërinë “****” sh.p.k.,¹² mbi ekzistencën e dy kontratave të furnizimit me UKT-në dhe OSHEE-në, për objektin në fjalë, shoqëria i ka shpjeguar se për arsye të kohës së gjatë, mbi 10 vjet, e ka të pamundur të konstatojë personin përgjegjës, sepse ka edhe kontrata të tjera me emra të shënuar në mënyrë fiktive dhe pa nënshkrimin e personit.

250. Nga kërkimet e bëra nga Komisioni, ne nuk mundëm të siguronim asnjë kontratë mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërive UKT dhe OSHEE. Këto shoqëri sqaruan se matësit janë vendosur herët në kohë dhe pa kontrata përkatëse, mbështetur vetëm në listat e sjella nga shoqëria ndërtuese.

251. Subjekti i rivlerësimit, në vijim sqaron se nga shoqëria “****” sh.p.k. është vënë në dijeni të të dhënave respektive për objektin në fjalë, i cili i përket shtetasit A. B, me të cilin ai deklaroi se nuk ka asnjë njohje.

252. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.07.2018, ku z. A. B deklaroi se është ai blerësi i këtij apartamenti dhe se ai ka paguar rregullisht pagesat e furnizimit me energji elektrike e ujë, me librezat të cilat mbanin emrin z. Artan Broci. Për neglizhencë, nuk i ka ndryshuar ato, si dhe nuk ka bërë ndonjëherë azhurnim të kontratave, por ka vazhduar t’i paguajë ato rregullisht, duke mos e menduar këtë si problem. Ai deklaronte se me z. Artan Broci nuk ka asnjë njohje.

253. Nga verifikimi rezultoi se kjo pronë është e regjistruar në regjistrin hipotekor në emër të shtetasit A. B. Faturat rezultuan të paguara rregullisht, kryesisht në arkat në zonën “****”, arka qendrore, posta, apo arka ZMK, në varësi të periudhave.

254. Subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe disa dokumente për komunikimin që ka pasur me UKT-në dhe OSHEE-në, nga ku rezultoi se, nga shoqëria UKT sh.a. u krye verifikimi, pas ankesës, dhe u bë ndryshimi i të dhënave referuar emrit të pronarit. Po ashtu, edhe nga shoqëria OSHEE sh.a. u bënë verifikimet e duhura dhe u morën masat e nevojshme për ndryshimin e emrit të kodit të kontratës me nr. ***, nga z. Artan Broci në z. A. B.

255. Mbetet e pasqaruar përse është shënuar emri i gjyqtarit në të dy kontratat e furnizimit të UKT-së dhe OSHEE-së së një apartamenti dhe pa asnjë lidhje. Verifikimi dhe përditësimi i të dhënave, kryer nga OSHEE-ja dhe UKT-ja, është bërë me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, por ai nuk provon pse këto kontrata kanë qenë në emër të z. Artan Broci, që prej vitit 2007 deri në kohën e përditësimit të fundit.

256. I paprovuar mbetet edhe fakti i përditësimit të të dhënave të OSHEE-së, kryer nga sistemi *online*, në janar të vitit 2018, ku rezultojnë të dhënat e z. Artan B. Broci dhe, për më tepër, është vendosur edhe numri personal i identifikimit, për më tepër që z. Artan Broci dhe z. A. B nuk njiheshin.

¹² Shih kërkesën e datës 26.06.2018 drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k.

257. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura nuk e bindën trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimi.

Konkluzione lidhur me vlerësimin e pasurisë

258. Në përfundim të analizës mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, bazuar në provat që u disponuan, në vlerësimin në tërësi të komponentit të pasurisë, si dhe në bindjen e brendshme, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të pasurisë, duke bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare, siç është rasti për shtëpinë e plazhit, në ***, Durrës dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj, si dhe rastet e parashikuara në pikat 217 e 224, të këtij vendimi.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me pasurinë e tij, siç janë rastet e parashikuara në pikat 40, 55 e 157 të këtij vendimi.
- iii. Gjatë hetimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit u konstatuan deklarime të pamjaftueshme dhe mungesë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë, siç janë rastet e parashikuara në pikat 105, 111, 156 e 157 të këtij vendimi.
- vi. Subjekti ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së shtëpisë në plazh, Durrës.
- vii. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasuri të fshehtë të padeklaruara, e cila mbahet nga persona të tretë, e trajtuar në pikën 248 - 257 të këtij vendimi.
- viii. Gjatë vlerësimit të pasurisë u konstatuan të paktën dy raste, për të cilat ai gjendet në situatën e konfliktit të interesit, të shprehura në pikat 58, 59 e 131 të këtij vendimi.

ii. KONTROLLI I FIGURËS

259. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin me nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci”. Ky raport është i deklasifikuar.

260. Për këtë dosje janë kryer këto procedura verifikimi.

261. I është kërkuar informacion Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me propozimin e Presidentit të Republikës për kandidaturën e z. Artan Broci si gjyqtar në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Ky institucion ka konfirmuar se ka propozuar z. Artan Broci për gjyqtar në Gjykatën e Krimeve të Rënda në vitin 2004. Presidenti i Republikës, i pyetur për këtë çështje, ka shpjeguar se nuk disponon informacion tjetër, përveç kërkesës së ardhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 2004.

262. Është kërkuar informacion nga institucionet ligjzbatuese mbi figurën e subjektit të rivlerësimit. Nga informacionet e mbledhura nuk ka pasur ndonjë informacion që të implikojë drejtpërdrejt subjektin e rivlerësimit në rrethana të ndryshme.

263. Nga Ministria e Drejtësisë kanë ardhur disa denoncime, ndër të cilat një ka qenë lidhur me komponentin e figurës. Nga Komisioni u kryen disa veprime për të kontaktuar me denoncuesin, por ato rezultuan të pasuksesshme, pasi ai nuk gjendej në adresat e deklaruara. Nga verifikimi në rrjetin *TIMS* u konstatua se ai banonte në Tiranë, por edhe jashtë shtetit dhe se ai ishte një person që kish pasur probleme me policinë në disa raste.

264. Në rezultatet e hetimit, është vënë në dijeni të këtij denoncimi edhe subjekti i rivlerësimit. Në vijim të shpjegimeve të tij dhe dokumentacionit të administruar në dosje, trupi gjykues i vlerësoi ato si të besueshme dhe se nuk ekzistojnë indice të bazuara në prova dhe në ligj lidhur me këtë denoncim.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

265. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

266. Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës.

iii. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

267. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Karriera e tij profesionale ka ardhur në rritje. Ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pa ndërprerje deri sot.

268. Sipas raportit për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka rezultuar:

268.1 Në lidhje me aftësitë profesionale

a) Identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Madje, në një rast, gjyqtari ka pasqyruar si pjesë e ligjit të zbatueshëm kontratën e lidhur midis palëve ndërgjyqëse e cila, referuar dispozitave civile materiale, ka forcën e ligjit. Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, ai përdor referenca nga jurisprudenca e vetë kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, nga jurisprudenca unifikuere e Gjykatës së Lartë dhe e Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga praktika e GJEDNJ-së dhe nga legjislacione të vendeve të ndryshme. Gjyqtari Broci evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente. Një rëndësi të veçantë i kushton edhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta. Vlen të theksohet se nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 2 prej tyre janë jashtë periudhës së rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016.

b) Në arsyetimin e vendimeve, gjyqtari Artan Broci i referohet edhe doktrinës shkencore të së drejtës procedurale civile të huaj, kryesisht asaj italiane, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka përdorur referencë edhe në fund të faqeve të vendimit. Në arsyetimin e vendimeve, ai përdor disa parime të rëndësishme të së drejtës, si detyrimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes, edhe kur ligji mungon apo është i paplotë; parimin se gjykata e njuh ligjin sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile dhe parimin e paanësisë, të lidhur ngushtësisht me parimin e barazisë së armëve dhe të pavarësisë.

Gjithashtu, në arsyetim jepet një interpretim nga pikëpamja teorike mbi: legjitimitetin procedural të palëve ndërgjyqëse, – mungesa e të cilit passjell pushimin e gjykimit të padisë dhe që rregullohet nga normat procedurale; dhe legjitimitetin substancial, – mungesa e të cilit sjell rrëzimin e padisë dhe që rregullohet nga normat materiale, në vështirim të nenit 468 të Kodit të Procedurës Civile, për rastet e pushimit të padisë, veçanërisht lidhur me “padinë që nuk mund të ngrihet”.

Vërehet se në rastin e disponimit për mospranim rekursi, vendimi është i paarsyetuar, pasi kjo pjesë e vendimit gjyqësor është vetëm 1 paragraf, me 1 ose 2 fjali, që përsëritin parashikimin ligjor. Megjithatë, ky lloj arsyetimi është i vlefshëm për qëllime të procesit të rregullt ligjor, sipas jurisprudencës konstante të Gjykatës Kushtetuese, e cila arsyeton se “nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Edhe GJEDNJ-ja ka pranuar se, kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një

çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës.

c) Në lidhje me aftësia organizative, subjekti është eficient dhe efektiv në punë, megjithëse rezulton të ketë pasur ngarkesë sasiore të lartë. Është konstatuar se ka pasur edhe raste të zgjatjes së procesit tej afatit maksimal të parashikuar. Është konstatuar se ka pasur raste të arsyetimit me vonesë të vendimit, duke mos u respektuar afatet ligjore. Vërehet se vonesa ka pasur edhe nga anëtarët e trupit gjykues në nënshkrimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara nga relatori Artan Broci.

268.2 Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale.

a) Subjekti ka reflektuar etik në punë. Z. Broci ushtron detyrën e kryetarit të Kolegjit Civil prej muajit maj të vitit 2015.

b) Nuk ka të dhëna në lidhje me mungesën e integritetit.

c) Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

268.3 Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

a) Aftësitë e komunikimit

Është konstatuar se mënyra e komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse ka qenë normale. Në disa raste nuk evidentohen të dhëna të tilla, pasi seancat janë zhvilluar në dhomë këshillimi dhe nuk është mbajtur procesverbal. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe depozitimim e dosjes në sekretarinë gjyqësore.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Në dhjetor të vitit 2013, ai ka filluar studimet e doktoratës pranë Katedrës Civile të Fakultetit të Drejtësisë. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, për shkak të detyrës së gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, nuk ka pasur detyrimin për t'u angazhuar në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës përgjatë periudhës së rivlerësimit. Ai ka marrë pjesë edhe në 3 aktivitete profesionale, me natyrë përfaqësuese në organizata ndërkombëtare për çështje të sistemit gjyqësor.

269. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 30.01.2018, na informon se ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, janë 7 ankesa të trajtuara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Pasi i ka shqyrtuar këto ankesa, ka arritur në konkluzionin se në bazë të ligjit nr.8811 të vitit 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa që nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor dhe ankimet mund të zgjidhen duke apeluar çështjet në gjykatën më të lartë. Ka pasur raste kur nga shqyrtimi i ankesave nuk është provuar shkelja e ligjit, që përbën shkelje të disiplinës. Në rastin e ankimit të shtetasës N. T, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar dosjen në kryesekretarinë e gjykatës mbas 28 ditësh, kur afati është 10 ditë, por kjo shkelje sipas inspektoratit nuk përbën shkelje discipline në kuptim të ligjit.

270. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) të dhënat e paraqitura në raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa më sipër, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci: “I aftë”.

iv. DENONCIME NGA PUBLIKU

271. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr.84/2016, janë paraqitur 27 denoncime, të cilat i janë vënë në dispozicion edhe subjektit të rivlerësimit.

272. Lidhur me këto denoncime u përzgjedhën shtatë prej tyre, për të cilat u kërkua vlerësim profesional nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

273. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. ***, datë 18.06.2018, si edhe nr. ***, datë 21.06.2018, dërgoi raport shtesë mbi analizën e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, nga ku rezultoi:

1. Dosje denoncimi, nr. *, datë 04.06.2018.**

Vendimi nr. ***, datë 24.05.2018, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë është dhënë në dhomë këshillimi dhe nuk ka relator subjektin e rivlerësimit, por një gjyqtar tjetër. Në bazë të nenit 90, pika 1, shkronja “b”, nënndarja “i” dhe nenit 91, pika 3, i ligjit nr. 96/2016, kjo çështje nuk përfshihet te burimet e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci.

2. Dosje denoncimi nr. * prot., datë 4.2.2018.**

Vendimi nr. ***, datë 27.02.2018, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë është dhënë në dhomë këshillimi dhe nuk ka relator subjektin e rivlerësimit, por një gjyqtar tjetër. Në bazë të nenit 90, pika 1, shkronja “b”, nënndarja “i” dhe nenit 91, pika 3, të ligjit 96/2016, kjo çështje nuk përfshihet te burimet e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci.

3. Dosje denoncimi, nr. * prot., datë 16.01.2018.**

Vendimi nr. ***, datë 11.11.2016, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë është dhënë në dhomë këshillimi, ku është vendosur mospranim rekursi të paraqitur nga të paditurit P. C e “****” sh.p.k. Relator i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit. Vendimi është i paarsyetuar, pasi pjesa përshkuese - arsyetuese e vendimit gjyqësor është vetëm 2 paragrafë dhe në një nga të cilët citohet përmbajtja e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

4. Dosje denoncimi, nr. * prot., datë 23.01.2018.**

Vendimi nr. ***, datë 16.03.2016, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, ku është vendosur pushimi i gjykimit për shkak të heqjes dorë nga gjykimi. Relator i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit.

Nga pjesa arsyetuese e vendimit gjyqësor, rezulton se nuk citohet koha e paraqitjes së kërkesës nëse kishte filluar apo jo relatimi në seancë gjyqësore; nuk citohet akti i përfaqësimit të palës që ka paraqitur rekurs dhe nuk arsyetohet plotësimi i kushtit ligjor parashikuar në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile, nëse avokati i të paditurit ka tagër të shprehur në prokurë për ushtrimin e kësaj të drejte ekskluzive të të përfaqësuarit. Arsyetimi i vendimit në këtë drejtim ka mangësi të dukshme.

5. Dosje denoncimi nr. * prot., datë 15.02.2018.**

Vendimi nr. ***, datë 03.05.2016, i kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuesit “****” sh.p.k., me objekt: “Pezullim i ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 16.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 30.03.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me anë të këtij vendimi në dhomën e këshillimit është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimeve të sipërcituara. Relator i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit.

Nga analiza e vendimit për efekt vlerësimi profesional, konstatohet se ai është i paarsyetuar. Në vendim nuk pasqyrohen shkaqet për të cilat kërkuesi ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit, nuk citohet neni 479 i Kodit të Procedurës Civile dhe nuk argumentohet në vijim se cili prej kushteve të kësaj dispozite është plotësuar në rastin konkret. Nuk ka asnjë argument nëse pezullimi është dhënë për shkak të pasojave të rënda e të pariparueshme që mund të vinin në rastin konkret dhe këto duhej të provoheshin në gjykim, apo nëse është dhënë mbi bazën e një

garancie materiale të depozituar nga pala që ka bërë rekursin, garanci që siguron ekzekutimin e vendimit, apo nëse ekzekutojnë njëkohësisht të dyja këto kushte. Pra, është një vendim që nuk ka asnjë të dhënë mbi rrethanat për të cilat është kërkuar pezullimi, cilat shkaqe ligjore janë plotësuar për pranimin e një kërkitimi të tillë.

Ky vendim nuk plotëson standardin e një vendimi të arsyetuar për efekt të procesit të rregullt ligjor, referuar nenit 6 të KEDNJ-së, si edhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës Shqipërisë.

6. Denoncimi në lidhje me çështjen civile në Gjykatën e Lartë, nr. *.**

Kancelari i Gjykatës së Lartë konfirmoi në rrugë elektronike se kjo çështje i ka kaluar për gjykim gjyqtarit relator Artan Broci. Statusi i çështjes është “studim i çështjes” dhe dosja nuk është tërhequr nga arkivat e gjykatës. Për sa kohë që çështja është ende e pagjykuar, nuk ka burim për vlerësim profesional për llogari të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, subjektit të rivlerësimit Artan Broci, pasi nuk ka akte të prodhuara e të përfunduara prej tij për këtë qëllim, referuar nenit 77 të ligjit nr. 96/2016.

7. Denoncimi në lidhje me çështjen civile në Gjykatën e Apelit Tiranë, me nr. *, e vitit 2010.**

Nga aktet e përcjella për vlerësim rezulton se kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë 9 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 23.07.2010 -17.05.2010, tej afatit 6-mujor të parashikuar në shkronjën “H” të pikës 5 të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Gjithashtu, në këto akte rezulton se dorëzimi i vendimit të arsyetuar është bërë për një periudhë prej 4 muajsh dhe 4 ditësh nga shpallja, duke u dorëzuar më datë 21.09.2011. Ky afat është dukshëm në tejkalim të afatit ligjor 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

274. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar lidhur me 27 denoncimet e vëna në dispozicion, se:

“Në vlerësimin tim, të gjitha denoncimet e palëve që kam gjykuar, të cilat m’i keni sjellë në vëmendje, janë për shkaqe të cilat këto palë duhet t’i kanalizojnë nëpërmjet ankimit apo rekursit në gjykatën më të lartë me juridiksion rishikues.

Për sa u përket akuzave për korrupsion, vlerësoj se janë pretendime të ngritura nga palët e pakënaqura nga vendimet gjyqësore të shpallura nga unë.

Duke u njohur me të gjitha ankimet, konstatoj se në një pjesë të madhe të tyre unë nuk kam qenë relator. Ka edhe nga ato raste për të cilat, edhe pse kam hequr dorë, palët përsëri ankohen (si p.sh. rasti i z. S. R). Po ashtu, ka dhe raste ku ju drejtohen juve, si Komision, që të ndërhyini, në mënyrë që unë të heq dorë nga gjykimi i çështjes, kur në fakt e kam bërë dhe nuk është pranuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë. Në këto raste, pala, nëse ka ndonjë pretendim për njëanshmërinë time, duhet ta paraqesë në formën e kërkesës për përjashtim (si p.sh. rasti i znj. O. Gj apo rasti i z. G. T si përfaqësues i “Organizatës Sindikale të Pavarur të Naftës Patos”, për të cilën kam hequr dorë nga gjykimi që më datë 12.12.2017, kërkesë e cila është miratuar më datë 20.12.2017). Ka dhe nga ato palë që ankohen për pezullimet, për të cilat po ju paraqes disa praktika të një standardi të ri të vendosur nga kolegji civil pas ndryshimeve të KPC. Në raste të tilla, kërkesat për pezullim jepen me garanci pasurore apo edhe ankesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke u bazuar në një urdhër tashmë të shfuqizuar të kryetarit të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, po ju paraqes standardin që unë mbaj kur ia paraqes kryetarit të Gjykatës së Lartë kërkesën për përshpejtimin e gjykimit të çështjes duke ju dërguar disa raste.”

275. Deri në datën e seancës dëgjimore, për subjektin e rivlerësimit erdhën edhe 6 denoncime të tjera, duke e çuar numrin e denoncimeve në 33 gjithsej. Në denoncimet e paraqitura qytetarët pretendonin dhënie vendimi të padrejtë dhe veprime korruptive, në disa raste ata denonconin për shkelje ligjore, zvarritje të procesit në mënyrë të qëllimshme, në disa raste edhe për mungesë të aftësive profesionale dhe figurën e gjyqtarit.

276. Në Fletoren Zyrtare, nr. ***, të vitit 2016, u konstatua se ishte botuar Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. ***, datë 19.07.2016, me objekt: shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 16.07.2015 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Ky vendim mbështetej në ankesën e shtetasit V. Ç dhe vendimi nr. ***, datë 16.07.2015, të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) kishte gjyqtar

relator Artan Broci. Në bazë të nenit 49, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e konsideron këtë vendim si fakt të prezumuar nga ligji, i cili nuk ka nevojë për prova të mëtejshme.

277. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. ***, datë 19.7.2016, në pjesën arsyetuese konstatuam se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Broci, ka kryer shkelje në vendimin nr. ***, datë 16.7.2015, si më poshtë:

*“Parimi i paanësisë nuk është respektuar as në gjykimin në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari Artan Broci, i cili ka qenë relator i çështjes, ka marrë pjesë më parë në gjykimin e një çështjeje tjetër me të njëjtët paditës për shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 16.9.2000, të KKKP-së, gjykim që ka përfunduar në favor të këtyre subjekteve me vendimin nr. 364, datë 24.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

31. Gjykata konstaton se gjyqtari Artan Broci ka gjykuar në themel çështjen lidhur me shfuqizimin e vendimi nr. ***, datë 04.09.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke vendosur shfuqizimin e këtij vendimi e, për rrjedhojë, konfirmimin e ligjshmërisë së vendimit nr. ***, datë 16.9.2000, të KKKP-së Tiranë.

32. Gjykata, gjithashtu, konstaton se bazuar në materialet e dosjes, subjektet e interesuara Ferik Llagami etj., i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar për shkak se zvarritja e mëtejshme e çështjes do të sillte dëm ekonomik. Në vijim të kësaj shkrese, gjyqtari relator Artan Broci, me shkresë drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë, është shprehur se “çështja përfshihet në ato raste për t’u gjykuar me procedurë të përshpejtuar, për faktin se paditësi është njohur pronar mbi sipërfaqen objekt konflikti dhe, për më tepër, i është dhënë edhe e drejta e parablerjes së këtyre objekteve dhe zgjatja e mëtejshme e gjykimin do të bënte që subjektet e interesuara të humbasin të drejtat e fituara me vendim të KKKP-së”.

33. Gjykata, bazuar në rrethanat e mësipërme të çështjes konkrete dhe në standardet e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese për parimin e paanësisë, vlerëson se pjesëmarrja e gjyqtarit Artan Broci në dhënien e vendimit nr. ***, datë 24.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në dhënien e vendimit nr. ***, datë 16.07.2015, të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanësisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e testit objektiv të këtij parimi.

34. Në përfundim, gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit V.Ç, se Gjykata e Lartë gjatë gjykimin ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e parimit të paanësisë, është i bazuar dhe se kërkesa duhet të pranohet.”

IV. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

278. Z. Artan Broci ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të tij, duke u përgjigjur brenda një kohe të shpejtë, kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

279. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, denoncimet nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, faktet e prezumuara nga ligji sipas nenit 49, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- b) Në analizë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, të denoncimeve të ardhura nga publiku, për subjektin e rivlerësimit, si dhe mosndërmarrja e veprimit ligjor, lidhur me deklarin e konfliktit të interesit, të paktën në një rast, në vendimin nr. 396, datë 19.06.2014, të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, gjykojmë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Lartë Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall më datë 31.07.2018, ora 14:30.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine
Kryesues/Kundër

Valbona Sanxhaktari
Relator

Etleda Çiftja
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM NR. 4

TRUPI GJYKUES NR. 4

Sot, më datë 08.10.2018, ora 13:00, trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare,

u mblodh për t'u njohur me kërkesën e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, për korrigjimin e një gabimi material në datën e vendimit të publikuar për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci.

Konstatohet se në vendimin nr. 53 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Broci, përkrah numrit të vendimit është vendosur data 30.07.2018, në vend të datës 31.07.2018. Mbështetur në konstatimin e këtij gabimi/lapsusi në zbardhjen e vendimit për subjektin e rivlerësimit Artan Broci, propozoj që në faqen 1 të vendimit, pas numrit të vendimit, data "30.07.2018" të zëvendësohet me datën "31.07.2018".

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ", sipas të cilit përcaktohet se:

"1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.

2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij".

Trupi gjykues, pasi konstatoi se kërkesa qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi), në faqen e parë të vendimit,

V E N D O S I:

1. Në faqen 1, të vendimit nr. 53, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Artan Broci, data “30.07.2018” të zëvendësohet me datën “31.07.2018”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi gjykues nr. 4

Xhensila Pine	(Kryesuese)
Valbona Sanxhaktari	(Relatore)
Etleđa Çiftja	(Anëtare)

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka